



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:095440

Datë: 05.12.2024

Numri i dokumentit: 06554654

PKR.nr.41/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Alban Ajvazi dhe gjyqtarët profesionistë Avni Sylja dhe Sulltane Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale kundër të akuzuarve: A.H, A.B.1, A.T, D.S dhe A.B.2 për shkak të veprës penale *Dhënie e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur më nenin 31 të KPRK-së, (sipas pikës IV të aktakuzës)*, L.B dhe B.P për shkak të veprës penale në bashkëkryerje *Dhënie e ryshfetit nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, (sipas pikës V të aktakuzës)*, A.H, M.Q, S.H.E, R.Q dhe A.B.2 për shkak të veprës penale në bashkëkryerje *Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 lidhur më nenin 31 të KPRK-së, (sipas pikës VI të aktakuzës)*, L.B, B.P dhe B.Z për shkak të veprës penale në bashkëkryerje *Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale në bashkëkryerje Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike nga neni 262 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, (sipas pikës VII të aktakuzës)*, “I.1...” sh.p.k - (person juridik), “I.2...” sh.p.k - (person juridik) dhe N.SH. “D...” - (person juridik) për shkak të veprës penale *Dhënie e ryshfetit nga neni nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur më nenin 40 par.1 të KPRK-së, (sipas pikës VIII të aktakuzës)*, “I.1...” sh.p.k - I... - (person juridik) dhe “I.2...” sh.p.k - E... - (person juridik) për shkak të veprës penale secili veç e veç *Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 të KPRK-së, (sipas pikës IX të aktakuzës)*, A.H, “I.1...” sh.p.k - (person juridik) për shkak te veprës penale *Shmangie nga tatimi nga neni 313 par. 3 lidhur më par.1 të KPRK-së*, L.B, “I.2...” sh.p.k - (person juridik), B.P, N.SH. “D...” - (person juridik), N.Z dhe NSH. “Z...” - (person juridik) për shkak te veprës penale *Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur më par.1 të KPRK-së, (sipas pikës X të aktakuzës)*, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale në Prishtinë, nën shenjen PPS.nr.93/2014,

PPN.nr.310/2015 të datës 14.06.2016, (tani e përfaqësuar nga Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda), pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 16.10.2024, në prezencën e Prokurores së shtetit, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, si dhe përkthyesve të gjuhës maqedone dhe turke, me datë 21.10.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 05.12.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I. A.H, nga i ati I. dhe e ëma G., e vajzërisë H., i lindur me ..., në S... Turqi, me vendbanim në Prishtinë, rr. "...", me nr. personal pasaportës ..., i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, ka te kryer fakultetin ekonomik dhe menaxhment, turk, shtetas i Republikës së Turqisë.

II. A.B.1, nga i ati G. dhe e ëma M., e vajzërisë I., i lindur me ..., në Prizren, me vendbanim në rr. "...", me nr. personal ..., i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, Magjistër i shkencave te farmacisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

III. B.P, nga i ati Zh. dhe e ëma A., e vajzërisë P., i lindur me ..., në ... Maqedoni, me vendbanim në rr. "...", Shkup, me nr. personal ..., i martuar, i gjendjes se mire ekonomike, "D..." i shkencave te mjekësisë - kardiolog intervent, maqedon, shtetas i Republikës së Maqedonisë.

IV. L.B, nga i ati A. dhe e ëma S., e vajzërisë H., i lindur me ..., Gjakovë, me vendbanim në Prishtinë, rr. "...", me profesion Mjek-Kardiolog, me nr. personal ..., i martuar, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

V. N.Z, nga i ati K. dhe ëma Sh., e gjinisë I., i lindur me datë ... në Podujevë, me vendbanim në Prishtinë, rr. "...", Ulpianë, mjekë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

VI. A.B.2, nga i ati I. dhe e ëma S., e vajzërisë Th., i lindur me ..., në Istog, me vendbanim në shtetin e Gjermanisë rr. "...", me nr. personal ..., i divorcuar, i gjendjes se mire ekonomike, ka te kryer fakultetin e mjekëses-specialist i Kardiologjisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Gjermanisë.

VII. D.S, nga i ati I. dhe e ëma N., e vajzërisë I., i lindur me ..., në ..., K. Likove, Maqedoni, me vendbanim në Fushë Kosovë, rr. "...", pn me nr. personal ..., i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, me profesion Mjek-Stomatolog, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

VIII. A.T, nga i ati N. dhe e ëma A., e vajzërisë D., i lindur me ..., në U., me vendbanim në S., K. Lipjan, zona industriale Graçanice, me nr. personal te leje qëndrimit ..., i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin, Kontabilitetit dhe Biologjisë, turk, shtetas i Republikës së Turqisë.

IX. M.Ç, nga i ati H. dhe e ëma Z., e vajzërisë A., i lindur me ..., Turqi, me vendbanim në Prishtine, Lagja Marigona Residence, rr. "...", me nr. personal ..., i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, mjek-Kardiolog, turk, shtetas i Republikës së Turqisë.

X. SH.E, nga i ati A. dhe e ëma I. e vajzërisë H., i lindur me ..., në Gjilan me vendbanim në Prishtine, rr. "...", me nr. personal ..., i martuar, i gjendjes se mire ekonomike, Mjek Kardiolog, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

XI. B.Z, nga i ati Q. dhe e ëma Z., e vajzërisë H., i lindur me ..., Gjakovë, me vendbanim në Prishtine, M..., me nr. personal ..., i martuar, i gjendjes se mire ekonomike, me profesion Mjek-Internist, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

XII. R.Ç, nga i ati Y. dhe e ëma F., e vajzërisë D., i lindur me ..., në Pejë, me vendbanim Prishtinë, rr. "...", me profesion Mjek-Kirurg kardiovaskular, me nr. personal ..., i martuar, i gjendjes se mire ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Të akuzuarit - Personat Juridik:

XIII. "I.1..." SH.P.K - I..., të cilin me autorizim e përfaqëson av. Mehmet Berisha, me NUI ..., e regjistruar me datë 28.12.2009, me adresë në "...", p.n në Graçanicë.

XIV. "I.2..." SH.P.K - E..., me përfaqësuesin e saj L.B, me NUI ..., e regjistruar me datë 17.10.2005, me adresë në "...", në Graçanicë, magjistratja Prishtinë - Ferizaj.

XV. N.SH. "D...", me përfaqësuesin e saj B.P, me NUI ..., e regjistruar me datë 17.10.2005, me adresë në "... " në Graçanicë, magjistratja Prishtinë - Ferizaj.

XVI. NSH. "Z...", me përfaqësuesin e saj N.Z, e regjistruar me datë 29.01.2010, me adresë rr. "... " në Podujevë.

Konform nenit 363 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së;

LIROHEN NGA AKUZA

I

Të akuzuarit: A.H, A.B.1, A.T, D.S dhe A.B.2, (të akuzuar sipas pikës IV të aktakuzës);

Sepse nga data 01 Janar 2011 e deri më datën 31 Dhjetor 2015 duke vepruar në bashkëkryerje më njëri tjetrin dhe mjekët - të pandehurit G.B.1, D.G, E.M, N.R, F.SH, N.Z, A.K, L.K, H.S, B.Z, H.H, B.G, M.A, R.E, F.S.1, F.S.2, B.K, S.GJ, F.S.3, A.L, A.B, G.B.2, H.Q, M.G, M.S, B.G, B.P, B.M, D.M, I.A, A.S, L.P, S.SH dhe P.A, në atë mënyrë që ishin marr vesh që pacientët që kanë shkuar për kontrole ne Institucionet publike shëndetësore, ku punonin të pandehurit e sipër përmendur, në vend që ti kryenin veprimet për të cilat ishin të autorizuar të respektonin mënyrën e referimit dhe pacientët t'i udhëzonin në njësinë kompetente invazive në Klinikën e Kardiologjisë në SHSKUK në Prishtinë, të njëjtit të mos vepronin në këtë mënyrë por pacientët t'i referonin dhe t'i dërgonin ne spitalin privat I... dhe për kto veprime u jepnin ryshfet, ashtu që për çdo pacientë që e dërgonin për vendosjen e stendave u jepnin nga 500 euro, ndërsa për koronarografi nga 150 euro. Të pandehurve që u jepnin ryshfet ishin si në vijim: G.B.1 21,985 €, D.G 11,225 €, E.M 7,850 euro, N.R 6,250 €, F.SH 5,150 €, N.Z 4,800 €, A.K 4,300 €, L.K 3,100 €, H.S 3,250 €, B.Z 2,850 €, H.H 2,520 €, B.G 2,500 €, M.A 1,500 €, R.E 2.535 €, F.S.1 2,250 €, F.S.2 1,200 €, B.K 1000 €, S.GJ 3,950 €, F.S.3 3,850 €, A.L 1,650 €, A.B 900, G.B.2 750 €, H.Q 830 €, M.G 600 €, M.S 500 €, B.G 300 €, B.P 100 €, B.M 100 €, D.M 100 €, I.A 1,935 €, A.S 1,200 € , L.P 850 €, S.SH 1,650 € dhe P.A 780 €, ndërsa këta të pandehur me veprimet e tyre - dërgimin ose referimin e pacientit në spitalin privat I... ia mundësonin këtij spitali përfitimin financiar për çdo pacient të dërguar shumat nga 700.00 € deri në 13,000.00 €, i cili përfitim për spitalin I..., jo vetëm nga këta të pandehur kishte arritur shumën prej 4,050,958.00 euro;-

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale Dhënie e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur më nenin 31 të KPRK-së.

II

Të akuzuarit: L.B dhe B.P, (të akuzuar sipas pikës V të aktakuzës);

Sepse nga data 01 Janar 2011 e deri më datën 31 Dhjetor 2015 duke vepruar në bashkëkryerje më njëri tjetrin dhe mjekët - të pandehurit: N.Z, SH.SH, I.A, S.SH, M.G, L.P, G.B.2, F.S.1, F.H, A.B, K.P, P.A, A.S, H.S, A.K, F.S.2, A.L, B.G, B.P, F.S.3, D.G, E.M, R.E, L.K dhe B.G, në atë mënyrë që ishin marr vesh pacientet kanë shkuar për kontrollë në Institucionet publike shëndetësore, ku punonin të pandehurit e sipër përmendur, në vend që ti kryenin veprimet për të cilat ishin të autorizuar - pacientët t'i udhëzonin në njësinë kompetentë invazive në Klinikën e Kardiologjisë respektonin në SHSKUK në Prishtinë, të njëjtit të mos vepronin në këtë mënyrë por pacientët t'i referonin dhe t'i dërgonin në spitalin privat - E... dhe për këto veprime u jepnin ryshfet, ashtu që për çdo pacientë që e dërgonin për vendosjen e stendave u jepnin nga 500 euro, ndërsa për koronarografi nga 150 euro. Të pandehurit që u jepnin ryshfet ishin si në vijim: N.Z- 3100 euro, SH.SH 3050 €, M.G - 1000 €, dhe F.S.2 - 100 e, si dhe të pandehurit I.A 1150 €, S.SH - 900 € dhe L.P - 150 € ndërsa i pandehuri B.G kishte marr ryshfet nga spitali E... përmes NSH "D..." në shumë prej 340 euro, ndërsa këta të pandehur me veprimet e tyre - dërgimin ose referimin e pacientit në spitalin privat E... ia mundësonin këtij spitali përfitimin financiar për çdo pacient te dërguar shumat nga nga 700.00 € deri në 13,000.00 €, i cili përfitim për spitalin E... jo vetëm nga këta të pandehur kishte arritur shumën prej 504,595.00 euro,-

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale në bashkëkryerje Dhënie e ryshfetit nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

III

Të akuzuarit: A.H, M.Q, SH.E, R.Q dhe A.B.2, (të akuzuar sipas pikës VI të aktakuzës);

Sepse nga data 01 Janar 2011 e deri më datën 31 Dhjetor 2015 të pandehurit M.Q, SH.E, R.Q dhe A.B.2, duke punuar si mjek në spitalin privat I..., duke vepruar në bashkëkryerje kanë trajtuar në mënyrë të pandërgjegjshme pacientë me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore duke përdor haptas mjete apo metoda të papërshtatshme të mjekimit, në atë mënyrë që pacientëve u kanë thënë së ua kanë vendosur stendat, mirëpo pas kontrollave që pacientët kishin bërë në QKUK

ose jashtë vendit ishte konstatuar së nuk i kanë të vendosura stendat ashtu siç i kishin paguan në spitalin I... dhe me këtë kanë shkaktuar keqësimin e gjendjes shëndetësore dhe për një numër të personave që kishin trajtuar këta të pandehur kishin shkaktuar edhe vdekjen e tyre, mirëpo të njëjtit rreth qëllim të fshehjes së shkakut të vdekjes në bashkëkryerje me të pandehurin A.H i cili ishte drejtor i spitalit I..., nuk kishin kërkuar që të bëhen obduksionet, ashtu siç kërkonte ligji në fuqi për shëndetësi nr.2004/4 i vitit 2004, neni 83.2 dhe 84.1 pika b, edhe pse sipas këtij ligji vërtetimi i shkakut të vdekjes së personit i cili ka vdekur në institucionin shëndetësor ishte përgjegjësi e atij institucioni shëndetësor, sepse në rastet kur qytetari ka vdekur në institucionin shëndetësor, të tipit spitalor, brenda 72 orëve nga pranimi, sipas këtij ligji obduksioni ishte i detyrueshëm. Në mesin e të dëmtuarve nga këta të pandehur ishin edhe: SH.F, SH.A, S.A, E.B, N.M, E.P, B.I, A.K, M.F, I.S, S.G, A.GJ, L.B, N.A, XH.K, K.G, T.G, J.M, M.D,-

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale në bashkëkryerje Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

IV

Të akuzuarit: L.B, B.P dhe B.Z, (të akuzuar sipas pikës VII të aktakuzës);

Sepse nga data 01 Janar 2011 e deri më datën 31 Dhjetor 2015, në bashkëkryerje me njëri tjetrin kanë trajtuar pacientë me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore duke përdor haptas mjete apo metoda të papërshtatshme të mjekimit në atë mënyrë që pacientëve u kanë thënë së ua kanë vendosur stendat, mirëpo pas kontrolleve që pacientët kishin në QKUK ose jashtë vendit ishte konstatuar së nuk i kanë të vendosura stendat ashtu siç i kishin paguan në spitalin E... dhe me këtë ua kanë shkaktuar keqësimin e gjendjes shëndetësore dhe për një numër të personave që kishin trajtuar këta të pandehur edhe vdekjen e tyre, mirëpo të njëjtit rreth qëllim të fshehjes së shkakut të vdekjes nuk kishin kërkuar që të bëhen obduksionet, ashtu siç kërkonte ligji në fuqi për shëndetësi nr.2004/4 i vitit 2004, neni 83.2 dhe 84.1 pika b, edhe pse sipas këtij ligji vërtetimi i shkakut të vdekjes së personit i cili ka vdekur në institucionin shëndetësor ishte përgjegjësi e atij institucioni shëndetësor dhe në rastet kur qytetari ka vdekur në institucionin shëndetësor, të tipit spitalor brenda 72 orëve nga pranimi, sipas këtij ligji obduksioni ishte i detyrueshëm. Në mesin e të dëmtuarve nga këta të pandehur ishin edhe SH.B, SH.M, N.P, M.M, A.S, M.B, E.M, H.C, R.B, I.M, B.R, I.A, SH.A, E.A, B.Q, S.O, N.M, A.H, G.H, A.K.G, S.E, M.V, M.I,-

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale në bashkëkryerje Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

V

Të akuzuarit: "I.1..." sh.p.k - (person juridik), "I.2..." sh.p.k - (person juridik) dhe N.SH. "D..." - (person juridik), (të akuzuar sipas pikës VIII të aktakuzës);

Sepse nga data 01 Janar 2011 e deri më datën 31 Dhjetor 2015 duke vepruar si persona juridik, kanë futur në sistemin e tyre të pagesave edhe pagesat për mjeket që kanë punuar në Institucionet Publike Shëndetësore në Kosovë, me të cilët janë marr vesh për ti dërguar pacientët nga ato Institucione ne spitalet private dhe atë: në spitalin privat "I.1..." sh.p.k. - I..., drejtor i të cilit është i pandehuri A.H dhe spitalin privat "I.2..." sh.p.k. - E..., drejtor i të cilit ishte i pandehuri L.B, ndërsa këta persona juridik, duke përfshirë edhe NSH "D...", drejtor i të cilit ishte i pandehuri B.P, u kanë dhënë si ryshfet të pandehurve të përfshirë në pikën IV të këtij diapozitivi, në atë mënyrë që ata të tejkalojnë dhe të veprojnë në kundërshtim me autorizimet e tyre zyrtare duke dërguar ose referuar pacientë më sëmundje kardiake në spitalet private I... dhe E... dhe për çdo pacientë të dërguar, u kanë dhënë nga 500 euro, nëse i janë vendosur stendat ose 150 euro nëse pacientit të dërguar i është bërë vetëm koronarografia, ndërsa kanë përfituar për vete si në vijim: spitali I... shumën prej 4,050,958.00 euro dhe spitali E... shumën prej 504,595.00 euro,-

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale Dhënie e ryshfetit nga neni nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur më nenin 40 par.1 të KPRK-së.

VI

Të akuzuarit: "I.1..." sh.p.k - I... - (person juridik) dhe "I.2..." sh.p.k - E... - (person juridik), (të akuzuar sipas pikës IX të aktakuzës);

Sepse nga data 01 Janar 2011 e deri më datën 31 Dhjetor 2015 të pandehurit M.Q, SH.E, R.Q dhe A.B.2 që punonin në spitalin privat I..., kanë trajtuar në mënyrë të pandërgjegjshme pacientë me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore duke përdor haptas mjete apo metoda të papërshtatshme të mjekimit, në atë mënyrë që pacientëve u kanë thënë së ua kanë vendosur stendat, mirëpo pas kontrollova që pacientët kishin në QKUK ose jashtë vendit ishte konstatuar së nuk i kanë të vendosura stendat ashtu siç i kishin paguan në spitalin I... dhe me këtë kanë shkaktuar keqësimin e gjendjes shëndetësore dhe për një numër të personave që kishin trajtuar

këta të pandehur kishin shkaktuar edhe vdekjen e tyre, mirëpo të njëjtit më qëllim të fshehjes së shkakut të vdekjes në bashkëpunim më të pandehur A.H i cili ishte drejtor i spitalit I..., nuk kishin kërkuar që të bëhen obduksionet, ashtu siç kërkonte ligji në fuqi për shëndetësi nr.2004/4 i vitit 2004, neni 83.2 dhe 84.1 pika b, edhe pse sipas këtij ligji vërtetimi i shkakut të vdekjes së personit i cili ka vdekur në institucionin shëndetësor ishte përgjegjësi e atij institucioni shëndetësor, sepse në rastet kur qytetari ka vdekur në institucionin shëndetësor, të tipit spitalor brenda 72 orëve nga pranimi, sipas këtij ligji obduksioni ishte i detyrueshëm. Në mesin e të dëmtuarve nga këta të pandehur spitalin I... ishin edhe SH.F, SH.A, S.A, E.B, N.M, E.P, B.I, A.K, M.F, I.S, S.G, A.GJ, L.B, N.A, XH.K, K.G, T.G, J.M, M.D, ndërsa të pandehurit B.P, L.B dhe B.Z në bashkëpunim më njëri tjetrin kanë trajtuar në mënyrë të pandërgjegjshme pacientë me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore në atë mënyrë që duke punuar në institucionin shëndetësor "I.2..." sh.p.k." që kohë pas kohe ishte i pa licencuar dhe duke punuar vetë kohë pas kohe si mjek të pa licencuar në këtë institucionin shëndetësor, kanë trajtuar pacientë me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore duke përdorur haptas mjete apo metoda të papërshtatshme të mjekimit në atë mënyrë që pacientëve u kanë thënë së ua kanë vendosur stendat, mirëpo pas kontrolleve që pacientët kishin në QKUK ose jashtë vendit ishte konstatuar së nuk i kanë të vendosura stendat ashtu siç i kishin paguan në spitalin E... dhe me këtë ua kanë shkaktuar keqësimin e gjendjes shëndetësore dhe për një numër të personave që kishin trajtuar këta të pandehur edhe vdekjen e tyre, mirëpo të njëjtit më qëllim të fshehjes së shkakut të vdekjes nuk kishin kërkuar që të bëhen obduksionet, ashtu siç kërkonte ligji në fuqi për shëndetësi nr.2004/4 i vitit 2004, neni 83.2 dhe 84.1 pika b, edhe pse sipas këtij ligji vërtetimi i shkakut të vdekjes së personit i cili ka vdekur në institucionin shëndetësor ishte përgjegjësi e atij institucioni shëndetësor dhe në rastet kur qytetari ka vdekur në institucionin shëndetësor, të tipit spitalor, brenda 72 orëve nga pranimi, sipas këtij ligji obduksioni ishte i detyrueshëm. Në mesin e të dëmtuarve nga këta të pandehur në spitalin E... ishin edhe: SH.B, SH.M, N.P, M.M, A.S, M.B, E.M, H.C, R.B, I.M, B.R, I.A, SH.A, E.A, B.Q, S.O, N.M, A.H, G.H, A.K.G, S.E, M.V, M.I,-

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale secili veç e veç Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 të KPRK-së.

VII

Të akuzuarit: A.H, "I.1..." sh.p.k - (person juridik), (të akuzuar sipas pikës X të aktakuzës);

Sepse nga data 01 Janar 2011 e deri më datën 31 Dhjetor 2015 u janë shmangur pagesave të tatimit dhe kontributeve pensionale, në atë mënyrë që Institucioni privat shëndetësor - "I.1..."

Sh.P.K. si person juridik, drejtor i të cilit është i pandehuri A.H për vitet 2011, 2012, 2013, 2013, 2014 dhe 2015 i janë shmangur pagesës së tatimit dhe kontributeve pensionale në shumën prej 83,691.77euro,

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale *Shmangie nga tatimi nga neni 313 par. 3 lidhur më par.1 të KPRK-së.*

VIII

Të akuzuarit: L.B dhe "I.2..." sh.p.k - E... – (person juridik), (të akuzuar sipas pikës X të aktakuzës);

Sepse u janë shmangur pagesave të tatimit dhe kontributeve pensionale, Institucioni privat shëndetësor - "I.2..." Sh.P.K. si person juridik, drejtor i të cilit është L.B për vitet 2011, 2012, 2013, 2013, 2014 dhe 2015 i janë shmangur pagesës së tatimit dhe kontributeve pensionale në shumë prej 49,392.57euro,-

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale *Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur më par.1 të KPRK-së.*

Sepse nuk është provuar se të akuzuarit ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Konform nenit 362 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së;

REFUZOHET AKTAKUZA

IX

Ndaj të akuzuarve: L.B, B.P dhe B.Z, (të akuzuar sipas pikës VII të aktakuzës);

Sepse nga data 01 Janar 2011 e deri më datën 31 Dhjetor 2015, në bashkëkryerje me njëri tjetrin kanë ushtruar në mënyrë të kundërligjshme veprimtarinë mjekësore në atë mënyrë që duke punuar në institucionin shëndetësor "I.2..." sh.p.k." që kohë pas kohe ishte i pa licencuar dhe duke punuar vetë kohë pas kohe si mjek të pa licencuar në këtë institucionin shëndetësor,

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale në bashkëkryerje *Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike nga neni 262 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

X

Ndaj të akuzuarve: B.P, N.SH. "D..." - (person juridik), N.Z dhe NSH. "Z..." - (person juridik), (të akuzuar sipas pikës X të aktakuzës);

Sepse nga viti 2012, 2013 dhe 2014 u janë shmangur pagesave të tatimit dhe kontributeve pensionale, në atë mënyrë që Institucioni privat - N.SH. "D..." si person juridik, drejtor i të cilit është i pandehuri B.P i janë shmangur pagesës së tatimit dhe kontributeve pensionale në shumë prej 17.265.38 euro, dhe i pandehuri N.Z pronar i N.SH. "Z...", i janë shmangur pagesës së tatimit dhe kontributeve pensionale në shumën prej 22.883.33 euro,-

- Me këtë kishin për të kryer veprën penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së,-

Sepse ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Të dëmtuarit: A.GJ nga Prishtina, rr. "...", E.B nga Prishtina, lagja ..., I.A nga fshati ..., Komuna e Malishevës, L.B nga fshati ..., Komuna e Mitrovicës, M.V nga fshati ..., Komuna Prishtinës, ..., M.I nga fshati ..., Komuna Vushtri, M.D nga fshati ..., Komuna Gjilan, N.M nga Fushë Kosova, rr. "...", R.B nga Peja rr. "...", S.A, nga Mitrovica, rr. "...", SH.A nga Prishtina, rr. "...", p.n, SH.M nga Skenderaji, rr. "...", A.S nga fshati ..., Komuna e Podujevës, A.K.G nga Prishtina, lagja ..., M.M nga Prishtina, rr. "...", N.A nga Prishtina, rr. "...", dhe N.P nga Mitrovica, rr. "...", për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, gjykata me vendim të posaçëm do ta liroj dorëzanin për të pandehurit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzë nën shenjen PPS.nr.93/2014, PPN.nr.310/2015 të datës 14.06.2016, me gjithsejte 10 (dhjetë) dispozitiva, që përfshijnë 59 (pesëdhjetenëntë) të akuzuar, nga të cilët katër persona juridik, 176 persona të propozuar në cilësi të dëshmitarëve me numër të madh të provave materiale, që së bashku e bënin rastin të ndërlikuar,

andaj kjo gjykatë me aktvendimin PKR.nr.682/14 të datës 26.02.2018 komform nenit 36 par.1 lidhur me par.2 të KPPK-së, me qëllim të funksionimit të zbatimit më efikas të kësaj çështjeje penale ka vendosur ndarjen e të njëjtës në tri pjesë dhe vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor në tri procedura të ndara. Rrjedhimisht, në kuadër të një procedure penale, është vendosur të përfshihen të akuzuarit nga pika II dhe III e aktakuzës përfshirë edhe gjashtë të akuzuarit për të cilët gjykata më pas ka ndarë procedurën dhe tre personat e akuzuar për të cilët gjykata ka pushuar procedurën për shkak të vdekjes së tyre gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor. Kjo aktakuzë është ndarë në 4 (katër) pjesë. E po ashtu vlen të theksohet se nga Gjykata Themelore në Prishtinë deri më tani janë nxjerrë tri Aktgjykime të cilat njihen me emrin si Stenta I, Stenta II dhe Stenta IV.

Ndërsa përfundimisht të akuzuarit si në hyrje të këtij aktgjykimi janë pjesë e aktakuzës që njihet si Stenta III në këtë çështje penale dhe atë të akuzuarit: A.H, A.B.1, A.T, D.S dhe A.B.2 për shkak të veprës penale Dhënie e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, (sipas pikës IV të aktakuzës), L.B dhe B.P për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Dhënie e ryshfetit nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, (sipas pikës V të aktakuzës), A.H, M.Q, SH.E, R.Q dhe A.B.2 për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, (sipas pikës VI të aktakuzës), L.B, B.P dhe B.Z për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale në bashkëkryerje Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike nga neni 262 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, (sipas pikës VII të aktakuzës), “I.1...” sh.p.k - (person juridik), “I.2...” sh.p.k - (person juridik) dhe N.SH. “D...” - (person juridik) për shkak të veprës penale Dhënie e ryshfetit nga neni nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur me nenin 40 par.1 të KPRK-së, (sipas pikës VIII të aktakuzës), “I.1...” sh.p.k - I... - (person juridik) dhe “I.2...” sh.p.k - E... - (person juridik) për shkak të veprës penale secili veç e veç Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 të KPRK-së, (sipas pikës IX të aktakuzës), A.H, “I.1...” sh.p.k - (person juridik) për shkak te veprës penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 par. 3 lidhur më par.1 të KPRK-së, L.B, “I.2...” sh.p.k - (person juridik), B.P, N.SH. “D...” - (person juridik), N.Z dhe NSH. “Z...” - (person juridik) për shkak te veprës penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur më par.1 të KPRK-së, (sipas pikës X të aktakuzës).

Në prani të këtyre rrethanave, gjykata ka vazhduar me rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, ku janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datën: 21.03.2024, 26.03.2024, 23.07.2024,

15.10.2024 dhe 16.10.2024, në të cilat seanca kanë prezantuar prokurori i shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, si dhe të dëmtuarit-dëshmitarët: A.GJ, E.B, M.D, M.V, N.M, SH.A, SH.M dhe L.B, ku të akuzuarit në bazë të nenit 319 të KPPRK-së, janë udhëzuar me të drejtat e tyre ligjore dhe pas leximit të aktakuzës janë udhëzuar në bazë të nenit 321 par.1 të KPPRK-së, mbi të drejtat për deklarimin e pranimit apo mos pranimit të fajësisë, ku të akuzuarit janë deklaruar të pa fajshëm lidhur me veprat penale për të cilat akuzohen, ashtu që është dhënë fjala hyrëse e palëve, gjithashtu për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, është bërë administrimi i provave personale dhe materiale, është dhënë mbrojtja e të akuzuarit si dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurorja e Shtetit Bukuriye Gjonbalaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar, në të cilën thuhet se: Nga provat e siguruara gjatë procedurën hetimore dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të pandehurit e lartëcekur kanë kryer veprën penale që u vihet në barrë. Dëshmitarët e dëgjuar ne seancat gjyqësore ne mënyrë të qartë kane përshkruar ngjarjen se si kane shkuar neper Qendrat e mjekësisë ne regjionet ku kanë jetuar dhe si mjekët i dërgonin në këto dy spitale private I... dhe E..., dhe posa shkonin mjeket menjëherë i preferonin që të vendosin stendat dhe shumica e dëshmitarëve kane deklaruar se pas kontrolleve tjera te cilat i kane pasur te mjeket tjerë, mjeket i kane thënë se ju nuk keni te vendosura stenda, dhe te njëjtit e ndjejnë veten te dëmtuar dhe kane kërkuar kompensimin e dëmit. Në bazë të raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31.12.2013 rezulton se në spitalet private I... dhe E... trajtimi i pacientëve është dashur të bëhet pas konfirmimit që nuk ka kushte për trajtim të sëmundjes në institucionet publike shëndetësore. Megjithatë në rastet e testuar është gjetur se pacientët janë trajtuar pa një udhëzim të tillë. Gjithashtu sipas këtij raporti pas barazimeve financiare ka rezultuar se vetëm në dy këto institucione shëndetësore private kishte një shumë prej 125.582€ të paguara për të cilat këto institucione nuk kishin ofruar shërbime dhe se mungesa e raportimeve për kostot e trajtimit të pacientëve ka rritur dyshimin dhe mundësinë e keqpërdorimit të këtyre mjeteve. Mjeket që i kane referuar te shkojnë ne këto dy spitale private dhe shumicën e rasteve mjeket që i kane udhëzuar te shkojnë ne këto spitale vet i kane ftuar edhe ambulancën e këtyre spitaleve ,dhe te njëjtit kane shfaqur dyshimet e tyre se a kane pasur nevojë pre vendosjen e stendave pasi qe paraprakisht disa prej tyre kishin bere edhe kontrolla mjekësorë ku mjeket i kishën thënë se nuk keni te vendosur stenda. Mbrojtjen e të pandehurve gjykata duhet

ta merre si te pa bazuar sepse me këtë të pandehuri mundohen ti ikin përgjegjësisë penale për veprat e kryera penale, mbrojtja e tyre është në kundërshtim me të gjitha provat e siguruar gjatë hetimeve dhe te administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nga prezantimi i të gjitha këtyre provave dhe analiza e sipër përmendura, rezulton qartë së në veprimet e të pandehurve manifestohen të gjitha elementet e veprave penale qëju vihen në barrë. Andaj, Gjykatës i propozoj që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, e me rastin e vendosjes mbi dënim ti këtë parasysh të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese te parapara me ligj.

Mbrojtësi i të pandehurit A.H, av. Behar Ejupi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: duke u bazuar në nenin 353 të KPPRK-së mua si mbrojtës më lejohet që të komentoj pretendimet e prokurorit lidhur me atë se çfarë deklaroj sot para trupit gjykues edhe për të mbrojturin tim A.H meqë prokurorja e çështjes mbetet në tersi pranë aktakuzës për ne mbrojtja do të jetë shumë më e lehtë kur kemi parasysh faktin se aktakuza e cila është objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor ne kemi pas fatin që lidhur me këtë aktakuzë të kemi dy aktgjykime për fat të mirë Aktgjykime lirues, që nënkupton se provat të cilat i potencoj prokurorja e çështjes shumica e atyre provave janë administruar në këtë gjykatë dhe është marr Aktgjykim në emër të kësaj gjykate dhe unë shpresoj dhe besoj se edhe për A.H do të kemi një Aktgjykim lirues, sa i përket çështjes së veprave penale për të cilat akuzohet i mbrojturi im dhe prokurorja me asnjë fjali të vetme nuk tregoj se cilat janë provat me të cilat mund të vërtetohet se i mbrojturi im mund të këtë kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, unë e them me përgjegjësi të plotë se prokuroria ka gabuar periudhën kohore për të cilat pretendohet se i mbrojturi im ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, unë dua ta njoftoj TGJ se ai akuzohet për një periudhë kohore për të cilën nuk ka punuar në spitalin I...D, që nënkupton se i mbrojturi im ka filluar punën në vitin 2012 ndërsa nga Prokuroria akuzohet edhe për vitin 2011. Sa i përket çështjes së dhënies së rryshfetit unë dua të ju rikujtoj piken 3 të aktakuzës dhe piken 4, ku dallimi i vetëm ne mese pikës 3 dhe 4 është se në piken 3 është marr Aktgjykim lirues nga kjo gjykatë, në piken 3 fillon të Pandehurit etj, ndërsa në piken 4 të pandehurit A.H që dallimi i vetëm është që në piken 3 në fillim kemi mjeket për të cilët është nxjerr Aktgjykim lirues dhe i kemi të hijezuar me ngjyrë të zezë ndërsa sa i përket përshkrimit lidhur me veprimet e të pandehurve gjendet edhe emri i klientit tim, ndërsa në piken 4 në fillim është i hijezuar emri edhe i klientit tim ndërsa në pjesën e sqarimit janë “D...”ët G.B.1 etj, që për mua si mbrojtës por besoj edhe për TGJ është fare e lehtë të kuptohet se nuk mund me prova të njëjta nga e njëjta gjykatë të kemi Aktgjykim tjetër nga ai se çfarë është nxjerr në të kaluar lidhur me këtë Aktakuzë, sa i përket veprës trajtim i pa ndërgjegjshëm mjekësor lidhur me këtë pikë prokuroria le që nuk ofron asnjë provë por edhe është e habitshme se si tek të dhënat personale

në aktakuzën në të cilën mbetet pranë prokuroria e shtetit e ku klienti im me profesion është ekonomist ndërsa këtë veprë penale mund ta kryer vetëm mjeku, nga provat materiale dhe dëgjimi i dëshmitareve asnjë nuk ka mundur ta vërtetoj faktin se A.H ka të kryer fakultetin e mjekësisë dhe të ketë fituar titullin “D...”. Andaj i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim lirues për të mbrojturin e tij.

I pandehuri A.H në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: se e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, po ashtu shtoj se që nga viti 2012 kam punuar në kuadër të dispozitave ligjore të Kosovës.

Mbrojtësi i të pandehurit A.B.1, av. Florin Vertopi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e kam përgatitur në formë të shkruar, duke shtuar se aktakuza është totalisht e pa qëndrueshme sepse e njëjta nuk mbështetet në prova materiale dhe pjesën kualifikuese as që e ka trajtuar në diapozitiv të pikës 4, i cili i ka 27 rreshta i potencon 34 emra ndërsa në asnjë rresht nuk mund ta gjeni elementin inkriminues. I përmend emrat e të pandehurve të cilët janë liruar në dy procedurat tjera kjo i bije se janë liruar për marrje ryshfeti ndërsa këtë proces A.B.1 akuzohet për dhënie të ryshfetit, pa asnjë provë. Jo vetëm që nuk përshkruhen veprimet inkriminuese mirëpo prokuroria shkon edhe më lartë me shkelje të ligjit Penale, thotë se Astriti e ka kryer veprën penale për dhënie të ryshfetit nga neni 429 par. 2 dhe 3. Elementi kualifikues të paragrafit 3 nuk e gjeni do të, e përmban vete paragrafi 1 dhe 2 ndërsa paragrafi 3 e përmban vetëm paragrafin 1 jo dhe 2. Prandaj edhe në praktikumet e Kodit Penal është kërkuar të ndryshohet kjo normë mirëpo nuk është ndryshuar. Në këtë çështje i kam drejtuar fjalën përfundimtare me shkrim të gjitha pjesët që lidhen me kualifikimin juridik, dashjen dhe bash kryerjen dhe lidhjen kauzale, prandaj nuk do të merrem me elaborimin e tyre tani për tani. Gjatë këtij gjykimi janë dëgjuar tete dëshmitarë, asnjëri prej tyre në asnjë moment nuk e përmend A.B.1n dhe as të pandehurit tjerë si në diapozitiv të akuzës kështu që edhe kjo pjesë nuk do koment. Po ashtu janë lexuar deklaratat e 9 dëshmitareve, dhe asnjëri prej tyre në asnjë moment përsëri nuk e përmendin A.B.1n respektivisht asnjë dëshmitar nuk jep asnjë fakt që mund të lidhet me ndonjë element inkriminues për veprën penale për të cilën akuzohet por as për ndonjë vepër tjetër penale. Provat materiale të cilat janë administruar e duke ju përmbajtur edhe provave të cilat janë shpallur të pa pranueshme të njëjtat nuk argumentojnë elementet inkriminuese për të cilat po pretendohet nga prokuroria, as edhe një provë materiale. Lidhur me klientin tim mungojnë provat sepse prokuroria nuk ka arritur përtej dyshimit të bazuar ta vërtetoj para juve po e quaj teorinë e saj, sepse me të vërtete pretendimet në aktakuze kanë qenë vetëm supozuese

dhe asgjë nuk kanë vërtetuar, prandaj TGJ i propozojmë që të marr Aktgjykim lirues për A.B.1n pasi që nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se i njëjtit ta ketë kryer veprën penale sipas akuzës. Po ashtu kërkoj ta hiqni dorëzaninë e cila është caktuar me Aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake, ku është regjistruar hipoteka në dobi të KGJK-Gjykatës Themelore Prishtinë duke u bazuar në aktvendimin PPKR.nr.286/14 të datës 03.12.2014.

I pandehuri A.B.1, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe po ashtu shton se TGJ do të merr një vendim të merituar.

Mbrojtësi i të pandehurit B.P, av. Merita Stublla në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar, në të cilën thuhet se Aktakuza e dorëzuar nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në Gjykatë me provat e paraqitura nuk e ka bërë të besueshëm faktin se i mbrojturi im e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë. Andaj, si e tillë e paraqitur në Gjykatë për shqyrtim dhe vendosje nuk ka siguruar prova të pranueshme, si në aspektin e ligjshmërisë së tyre, e po ashtu edhe në aspektin e besueshmërisë me të cilat do të vërtetohej ekzistimi i dyshimit të bazuar se z. P... i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar. Më lejoni që edhe njëherë të tërheq vëmendjen tuaj lidhur me shkeljen e dispozitave ligjore dhe të drejtës kushtetuese ndaj z. P... përkatësisht parimeve universale e që kanë të bëjnë me të drejtën e përdorimit të gjuhës amtare në procedurë penale. Përkundër që shumë herë i kemi tërheq vëmendjen në Gjykatë për Prokurorinë Speciale se mos respektimi i kësaj të drejte përbën shkelje thelbësore dhe janë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale neni 14 par 2, neni 384 par 1 dhe nën par 1.12, Kushtetutës së Republikës së Kosovës nenet 3, 24, 29, 30 dhe 31 si dhe "Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut" neni 6 par (3) nën (e) lidhur me nenin 14 të Konventës dhe protokollet e saj ngase, dispozitat e këtyre akteve që i definojnë të drejtat e garantuara për të pandehurit/akuzuarit dhe standardet universale/ndërkombëtare të drejtësisë lidhur me të akuzuarin. Andaj, propozoj gjykatës që pas vlerësimit të provave të merrni aktgjykim pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet dhe atë në përputhje më nenin 363 par. 1, nën par. 1.1 dhe 1.3 të KPPK -së.

I pandehuri B.P, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe shtoj se trajtimi i cili i është bërë pacientëve, i njëjti është bërë sikur në SHBA dhe gjithkund tjetër dhe jam krenar për këtë periudhë për të cilën kam shërbyer në Republikën e Kosovës.

Mbrojtësi i të pandehurit L.B, av. Mustaf Kastrati, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar, në të cilën thuhet se gjatë shqyrtimeve është vërtetuar se aktakuza është e pabazuar në prova, është kundërthënëse, joargumentuese kurse për cilësimet nga Aktakuza mungojnë plotësisht provat dhe këto cilësime janë vetëm parafrazime të dispozitave ligjore . Edhe akuza për ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore është e pabazuar nga shkak se këto subjekte juridike kanë qenë të licencuara, me ofrimin e afatit të skadences kanë aplikuar për vazhdimin e saj por shteti nuk ka vendosur, punën nuk ua kanë ndaluar, dhe vetë Ministria e Shëndetësisë në heshtje ju ka vazhduar marrëveshjen me këto spitale, të pa licencuara këtu është kundërthënia e aktakuzës. Pretendimi i Prokurorisë në fq.42 kapitulli 7 i aktakuzës nuk është argumentuar me asnjë provë të vetme të mjekësisë ligjore, por thjesht është bartur nga deklaratimet e pa vërtetuara duke tentuar që të e cilësojnë si provë. Në rastet kur familjaret kanë kundërshtuar obduksionin, spitali nuk ka patur kompetenca që të i kundërshtojë vullnetin e tyre, sepse kërkesa e tyre që mos kryhet obduksioni vërtetohet se ata nuk ka ekzistuar dyshimi për shkakun e vdekjes. Edhe pretendimi nga kapitulli 8 i fq.43 është i paargumentuar me provat përkatëse dhe është e pakjartë se çfarë nënkuptojnë shumat e cekura në këtë kapitull, dhe nga kush i kanë përfituar këto shuma, edhe pse nga narrativi nënkuptohet se këto pagesa mbi bazën e marrëveshjes me Ministrin e Shëndetësisë janë inkasuar nga kjo Ministri e jo nga pacientet apo mjekët. Në shqyrtimin e datës 15.10.2024. Gjykata ka marrë aktvendim që provat e nxjerra në mënyrë jo të ligjshme të shpallen të pa pranueshme, andaj Aktakuza ka mbetur e paargumentuar sepse pjesa më e madhe e kësaj aktakuze ka qenë e hartuar dhe bazuar mbi këtyre prova të papranueshme. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të liroj nga akuza të mbrojturin e tij.

I pandehuri L.B, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: se e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam diçka tjetër çfarë të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit A.B.2, av. Fisnik Salihu në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar, në të cilën thuhet se prokuroria nuk i ka individualizuar veprimet e secilit të pandehur dhe nuk ka konstatuar se cilët pacientë kanë vdekur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të të ndërgjshme të pandehurit A.B.2, prokuroria nuk ka arritur me asnjë provë të vetme se i mbrojturi im kujt i ka dhënë rryshfetë dhe çfarë cilësie, madje në kohën kur akuzohet nga prokuroria se ai ka qenë duke punuar në institucionet shëndetsore kosovare, i njëjti veçësë ishte duke punuar në shtetin e Gjermanisë dhe atë nga fillimi i vitit 2013. Andaj i propozojmë gjykatës që merr aktgjykim lirues për të mbrojturin tim.

I pandehuri A.B.2 në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: se e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam diçka tjetër çfarë të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit D.S, av. Afrim Salihu në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar, në të cilën thuhet se pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetua me asnjë provë të vetme se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Sipas akuzës pretendohet se punonjësi brenda spitalit i paska dhënë ryshfete kolegut brenda spitalit, gjë që në procedurën e provave askund nuk është shqyrtuar dhe nuk është përmendur asnjëherë i mbrojturi im me emër. Andaj i propozojmë gjykatës që merr aktgjykim lirues për të mbrojturin tim.

I pandehuri D.S në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: se e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam diçka tjetër çfarë të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit A.T, av. Elisë Musa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar, në të cilën thuhet se prokuroria e ka ngritur aktakuzën duke u mbështetur në prova thellësisht të pa mbështetshme, pasi që provat duhet të jenë të artikulshme dhe duhet të specifikohen veprimet e të mbrojturit tim. Prokurori në asnjë moment nuk tregon asnjë element të bashkëpunimit në mes të akuzuarve, duke e marr parasysh se për të ekzistuar bashkëkryerja duhet të ekzistojë lidhja e caktuar objektive dhe subjektive, pas administrimit të provave është vërtetuar se në mes të mbrojturit tim dhe të bashkakuarve nuk ka pas asnjë lloj marrëveshje për të kryer veprën penale , andaj pa mëdyshje është vërtetuar se i mbrojturi im nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe i propozoj gjykatës që të merr aktgjykim lirues për të njëjtin.

I pandehuri A.T në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: se e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam diçka tjetër çfarë të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit M.Q, av. Albina Budakova në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar, në të cilën thuhet se pretendimet e aktakuzës nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova bindëse të cilat do të provonin se i mbrojturi im ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, për faktin se i njëjti nuk ka mjeta apo metoda të pa përshtatshme të mjekimit ose nuk ka përdor masat përkatëse higjienike me të cilat do të

shkaktonin keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit apo vdekjes së tyre dhe nëse i mbrojturi im ka vepruar kështu siç pretendon akuzua, kush e vlerësoi këtë, duke dhënë një mendim dhe konstatim profesional, me asnjë provë të vetme gjatë administrimit në shqyrtim gjyqësor nuk o vërtetua ky fakt, andaj mbi këtë bazë duhet të merret aktgjykim lirues për të njëjtin.

I pandehuri M.Q në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam diçka tjetër çfarë të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit SH.E, av. Florent Latifaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: sa i përket SH.E i njëjti së bashku me pesë të akuzuar të tjerë, në diapozitivin e 6 ta aktakuzës akuzohet se ka kryer veprën penale të veprimit të pandërgjegjshme mjekësor dhe atë në tri raste, në dy raste thuhet në bash kryerje të ndihmës mjekësore duke përdorur haptas mjete të pa përshtatshme të mjekimit, kjo është për J.M dhe T.G, sikur ta kishte marr mundimin ma të vogël, vetëm me lexua fletë lëshim e J.M kish me pa se këtë pacient nuk e ka trajtua SH.E por vetëm është nënshkruar për një mjek tjetër pasi që në momentin kur është lëshuar ky flete lëshim ka qene ky prezent. Kanë thënë se J.M kur ka shkuar në QKUK i kanë thënë nuk ti kanë vunë katër stenda por një, prape nuk e kanë marruar mundimin të i thërrasin e të i pyesin ata “D...” të QKUK-së ku është vërtetuar se është vetëm një stendë. E njëjta situatë është edhe me T.Gn, i kanë thënë mjeket në QKUK se ka më pak stenda se sa që i kanë thënë, as mundin më të vogël nuk është bere të i thërrasin këta mjek dhe të konstatojnë se a është kjo e vërtete. Në rastin e trete tek i ndjeri M.D thuhet se nuk kanë kërkuar që të i bëhet obduksioni, i njëjti thotë dëshmitarja M.D bashkëshortja e të ndjerit, 7 ditë pasi që është lëshuar nga spitali L.. i është keqësuar gjendja dhe e kemi dërguar në spitalin e Gjilanit e pastaj në QKUK dhe kishte vdekur pas një ore që kemi dërguar në L... Në asnjë ligj të Kosovës nuk thuhet se këta munden ta ndalojnë pacientin ta dërgojnë në obduksion këtë e vendos familja se a dëshirojnë ta dërgojnë në obduksion ose jo, nëse shteti nuk ka ndonjë dyshim rreth vdekjes së tij, për këto tri akuzohet për trajtim të pandërgjegjshëm mjekësorë. Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor sipas nenin 260 kryhet kur mjeku në rastin e dhënies së ndihmës e përdor haptas një mjet apo metode të pa përshtatshëm të mjekimit, ose nuk përdor masa përkatëse higjienike, tash nëse i kanë thënë i kemi vnu tri stenda dhe i kane vunë një atëherë cilën mase të pa përshtatshme ose mjete e kane përdorë apo mase higjienike, nëse nuk e kanë detyruar me zor me shkua me bërë obduksion cilën masë apo mjet të pa përshtatshëm e kane përdore, nëse një institucion si Prokuroria e Shtetit nuk është e gatshëm me bërë një identifikim të tillë atëherë nuk është qudi që janë akuzuar 60 mjekë, pasi që kane

mungese bazike të njohurisë në elementet e veprës penale dhe propozoj që SH.E të lirohet nga akuza në mungese të provave.

I pandehuri SH.E në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam diçka tjetër çfarë të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit B.Z, av. Osman Havolli në fjalën përfundimtare deklaron se: fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar, në të cilën thuhet se detyrat e të mbrojturit tim kanë qenë, që të bëjë analiza paraprake mjekësore e jo vendosjen e stendave ashtu siç pretendon prokuroria, kush nga ekspertet apo ekspertizat e vërtetoj një trajtim të pa ndërgjegjshëm mjekësor, askund nuk është vërejt një sjellje e mjekeve e cila do të ishte joprofesionale, jo morale dhe jo etike, andaj me asnjë provë personale dhe materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk mbështet pretendimi i prokurorisë dhe mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit B.Z.

I pandehuri B.Z në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: se e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam diçka tjetër çfarë të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit R.Q, av. Feim Alaj, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar, në të cilën thuhet se prokuroria ka dështuar që të sjellë prova të mjaftueshme që mbështesin fajësinë e të mbrojturit tim, pasi që edhe dëshmitaret e dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë dhënë deklarata kontradiktore. Raporti i autopsisë nga Flamur Blakaj konfirmon se gjendja e pacientit nuk ishte përkeqësuar nga trajtimi i dhënë nga R.Q, duke e përjashtuar përgjegjësinë e tij penale. Ana mbi këtë bazë i propozoj gjykatës që të merr aktgjykim lirues ndaj të mbrojturit tim.

I pandehuri R.Q në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: se e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam diçka tjetër çfarë të shtoj.

I pandehuri ““I.l...”” I... - (personi juridik), përmes përfaqësuesit të saj av. Mehmet Berisha, fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar dhe ka theksuar se aktakuza e ngritur ndaj I... është në kundërshtim me dispozitat ligjore të KPPRK-së, pasi që neni 101, par.2 thuhet se për veprat penale të dënueshme me 3 apo shumë vjet, është obligative të zhvillohet faza hetimore, e që në rastin konkret ky detyrim nuk u respektua nga prokuroria, e njëjta nuk ka arritur

me asnjë provë të vetme të vërtetoj dyshimin e bazuar mirë se kujt i ka dhënë ryshfet dhe në çfarë cilësie, deri më sot nuk ka asnjë person që është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për veprën penale marrje e ryshfetit nga i pandehuri I..., për çka i i njëjti nuk mund të dënohet për dhënie të ryshfetit, kur nuk ka asnjë provë se kush janë personat që kanë përfituar ryshfetin e supozuar nga prokuroria, mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim lirues ndaj të njëjtit.

I pandehuri ““I.2...”” SH.PK, përmes përfaqësuesit të saj L.B, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: është fakt se unë kam qene njeri nga aksionaret me 4.5% dhe e kam pasur cilësinë e drejtorit dhe i njëjti tash nuk është mbyllur.

I pandehuri N.SH ““D...”i”, përmes përfaqësuesit të saj B.P, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: firma NSH “D...”i është themeluar në emrin tim sipas ligjit të RKS, është paguar të gjitha tatimet e parapara dhe gjatë fazës të hetimeve kemi angazhuar ekspert financiar dhe sipas saj ka dal se kemi paguar më shume se sa detyrimet që kemi pasur, dhe i njëjti tash nuk është mbyllur

Procedura e Provave:

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarve shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjithashtu gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, ka dëgjuar të dëmtuarit-dëshmitarët: A.GJ, E.B, M.D, M.V, N.M, SH.A, SH.M dhe L.B, janë lexuar deklaratat e të dëmtuarve-dëshmitarëve: I.A të dhënë në prokurori me datë 12.11.2014, M.I të dhënë në prokurori me datë 03.12.2014, R.B të dhënë në prokurori me date 22.10.2014, S.A të dhënë në prokurori me date 11.11.2014, A.S të dhënë në prokurori me date 29.10.2014, A.K.G të dhënë në prokurori me datë 17.03.2016, M.M të dhënë në prokurori me date 26.01.2016, N.A të dhënë në prokurori me date 29.10.2014, N.P të dhënë prokurori me date 10.11.2014, si dhe bërë administrimin e provave, siç janë: Udhëzimi Administrativ nr.08/2007 për ofrimin e Shërbimeve Spitalore në Kosovë; Dosjet e pacientëve, të Ministrisë së Shëndetësisë për pagesat e shpenzimeve të trajtimit mjekësor në I... dhe E..., të cilave u janë bashkangjitur edhe tabelat e secilës dosje lidhur më atë së çka mungonte në këto dosje; Raporti i spitalit privat I... – së nr.4285

të dt.16.07.2014 rezulton se vetëm për periudhën 2010-2014 vetëm në kardiologjinë invazive kishin vdekur; Raporti i spitalit privat E... nr.50/2014 të dt.08.09.2014, rezulton se për periudhën 2009 – 2014 kishin vdekur 70 persona; Raporti nr. Ref.10/H-074-13 i datës 22.10.2013 i inspektimit specifik të Inspektionit Shëndetësor (ISH), ku Inspeksioni Shëndetësor kishte rekomanduar ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë shëndetësore të spitalit E... deri në licencim pranë MSH-së; Raporti Ref.nr.No.10/D-070-13 i datës 24.10.2013 i inspektimit specifik i Inspektionit Shëndetësor ku është rekomanduar që spitalit I... ti ndalohet ofrimi i shërbimeve shëndetësore në fushën e laboratorit hematologjik deri në licencim pranë MSH-së; Raporti i inspektionit shëndetësor i përpiluar me datë 09.10.2014 rezulton se spitali privat “I.2...” – E... edhe pas skadimit të licencës me datë 03.06.2014 kishte punuar pa licencë deri më datë 22.08.2014; Raporti i BQRL-së i datës 30/10/2013 i nënshkruar nga Kryesues Hysni Bajrami; Vendimi nr.10/R-23-13 i dt.28.10.2013 i Inspektoratit shëndetësor më të cilin ishte ndaluar ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore të mjekëve që vinin nga Republika e Maqedonisë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe atë: B.Pt, etj; Vendimi Nr.10/R-22-13 i dt.28.10.2013 i Inspektoriatit shëndetësor më të cilin ishte ndaluar ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore spitalit privat E...; Procesverbali nr.004945 të dt.09.10.2014 i Inspektoriatit shëndetësor më të cilin ishte pezulluar përkohësisht ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore të spitalit privat E...; Raporti i Policisë së Kosovës nr.06/03-267/15 të dt.03.08.2015 të cilit i janë bashkangjitur edhe përgjigja e Departamentit për zhvillim strategjik shëndetësor të MSH-së me numër 05-2731 i datës 21.05.2015 lidhur me spitalin E... dhe përgjigja e të njëjtit departament me nr. të protokollit 05-2961; Përgjigja për interpretim ligjor të lëshuar me datë 12.11.2013 me nr. 189/2013 nga Komisioni rregullativ i prokurimit publik; Përgjigja e Ministrisë së Shëndetësisë – Departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme që mbanë numrin 08 nr.05-930/2 i dt.16.03.2016, të cilit i janë bashkangjitur të dhënat për pagesat e shërbimeve mjekësore të ofruara për pacientët në spitalet private I... dhe E...; Raporti i bastisjes i dt.09.10.2014, lidhur me bastisjen e spitalit privat I..., dhe të pandehurit A.H; Raporti i bastisjes i dt.09.10.2014, lidhur me bastisjen e spitalit privat “I.2...” dhe zyrave të të pandehurve L.B dhe B.P; Raporti i ekspertizës për ekzaminimin e kompjuterëve të sekuestruar nga spitali privat I... nr. AKF-2014-0143 që është paraqitur nga Laboratori për ekzaminim të kompjuterëve i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, Dy fletoret e sekuestruara në spitalin privat I... dhe atë njëra me ngjyrë të zezë që në kopertinë mbanë shenjën BKT (Banka Kombëtare Tregtare) si dhe një fletore ngjyrë e kaltër e mbylltë në kopertinë e të cilës shkruan Kasa Defteri; Raporti i ekspertizës për ekzaminimin e kompjuterëve të sekuestruar nga spitali privat E... nr.AKF-2014/0141 që është paraqitur nga Laboratori për ekzaminim të kompjuterëve i Agjencisë së

Kosovës për Forenzikë; Fletoren e sekuestruar në spitalin privat E... që i përkiste të pandehurit B.P, me ngjyrë kafe në kopertinën e të cilës gjendet një tiketë e vendosur me numër 5 dhe shkrimin në çirilic “LIN – IMPEX”; Të shikohen CD-të lidhur me ekspertizën e kompjuterëve si dhe fletoret e lartcekura; Shkresa e spitalit privat “I.2...” – E... me nr.35 të dt.18.01.2016, lidhur më të punësuarit në spitalin E...; Shkresa e spitalit privat I... nr. 6094 të datës 15.01.2016 , lidhur më të punësuarit në spitalin I...; Raporti nr.06/03-947/14 i datës 29.12.2014 lidhur me masën e fshehtë të zbulimit të të dhënave financiare i cili është përgatitur nga eksperti i çështjeve ekonomike në Policinë e Kosovës që lidhen me L.B, B.P, A.H, A.B.1, N.Z; Raporti për të dhënat financiare nr.06/03-69/15 të dt.24.02.2015, lidhur me bizneset N.Sh “D...”; Raporti i Policisë së Kosovës për të dhënat financiare të Nsh “D...” nr.06/03-194/15 i datës 02.06.2015, të cilit i është bashkangjitur raporti i datës 19.03.2015; Raporti i Policisë së Kosovës për të dhënat financiare të Nsh “D...” nr.06/03-271/15 i datës 04.08.2015; Raporti i Policisë së Kosovës për të dhënat financiare nr.06/03-272/15 i datës 04.08.2015, të cilit i janë bashkangjitur raportet e datës 03.08.2015, të spitaleve I... dhe E...; Raportet për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit të datave:03.03.2014, 11.03.2014, 01.04.2014, 16.04.2014, për të pandehurit A.H (mos të merret parasysh pjesa e masave me D.G); të datave: 03.03.2014, 01.04.2014, 16.04.2014, 05.05.2014 dhe 15.05.2014 për të pandehurin L.B, të datave 27.01.2014, 01.04.2014, 16.04.2014, 05.05.2014, 15.05.2014, 03.03.2014, 30.01.2014, 14.05.2014, 22.05.2014 për të pandehurin N.Z, B.; Raporti i Administratës Tatimore të Kosovës NJHTI nr.116/2015 të datës 06.05.2015 sipas të cilit raport rezulton se N.sh “D...”; Raporti i Njësisë së Hetimeve Tatimore të ATK-së NJHTI nr.196/2015 i datës 04.08.2015; Përgjigjja e Departamentit për zhvillim strategjik shëndetësor të MSH-së me numër të njësisë 05-2381/2 të datës 05.05.2015 për N.sh. “D...” ku shihet së nuk kishin aplikuar asnjëherë për licencim në MSH – Bordin për licencim të institucioneve private shëndetësore; Raporti final i departamentit të hetimit tatimor dhe inteligjencës të ATK-së, DHTI nr.120/2016 të dt.28.04.2016 si dhe shkresave të bashkangjitura të këtij raporti; Raporti i auditimit të brendshëm për biznesin N.sh “ “D...”” për vitet 2012, 2013 dhe 2014 të cilin e ka sjellë në Prokurori vet përpiluesi i këtij raporti dëshmitari Y.SH, mbi bazën e këtyre provave, gjykata ka bërë vlerësimin dhe ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.03.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar A.GJ, i cili ka deklaruar se: në vitin 2012 ka pasur probleme me zemrën dhe fillimisht është drejtuar në emergjencë, pastaj prej aty me insistimin e “D...” M.G është drejtuar në spitalin E... dhe aty kanë intervenuar me dy stenta, më pas nga konsulta me “D...”in L.B pasi që i kishte thënë

se keni nevojë edhe për dy stenta tjera, janë dakorduar që pas 6 muajve të paraqitet prapë të i vendos edhe dy stenta të tjera. Në janar të vitit 2013 pasi që kanë kaluar 6 muaj, është paraqitur tek “D...”i L.B dhe me të njëjtin janë dakorduar që kësaj radhe stentat të i vendos më lirë ose njërën prej stentave të mos e paguaj. Pas vendosjes së stentave, pagesat i kanë kryer familjaret dhe kanë paguar vetëm për një stentë dhe vizitat shëndetësore pastaj i ka realizuar tek “D...” B... i cili ka shpjeguar se ku është e vendosur stenta dhe në atë vizite Dr. B... i ka thënë se nuk ka qenë e nevojshme të vendosen dy stenta. Në vitin 2014 pas vizitës në spitalin Amerikan, u takuam me “D...” B. dhe pasi që ka shikuar CD, i ka thënë se duhet të realizohet një bay pass, pasi që një damar është 90% jofunksional. Në Nëntor të vitit 2014 është realizuar BayPass në dy stentat e fundit që janë vendosur në spitalin E... pasi që është më i sigurt dhe i njëjti është bindur se në spitalin E... është vendosur vetëm një stendë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.03.2024, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar E.B, e cila ka deklaruar se: në vitin 2014 ka dhënë deklaratë në prokurori lidhur me këtë çështje dhe e njëjta deklaroi se nuk beson se vdekja e bashkëshortit të saj ka qenë natyrore, edhe pse rezultatet e obduksionit tregonin se vdekja ishte natyrore, po ashtu pohoi se bashkëshorti i saj ka qenë i sëmurë dhe i diagnostifikuar edhe para se të vizitonte spitalin I..., tutje deklaroi se “D...”i A.K dhe “D...” i R.M kanë qene kur është kontrolluar burri dhe kanë thënë se i njëjti ka nevojë për stenta ose baypass, po ashtu edhe “D...” R.Q pas ekzaminimit ka thënë se burri ka nevojë për intervenim.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 23.07.2024, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar M.D, e cila ka deklaruar se: M.D ka qenë bashkëshorti dhe i njëjti ka pas probleme me zemër, për trajtim mjekësor të paren herë e kemi dërguar në emergjencën e Gjilanit dhe prej aty na kanë propozuar spitalin “I.1...” dhe me ndihmën e parë kemi dërguar në këtë spital. Në “I.1...” thanë se bashkëshorti ka dy damar zemrës të mbyllur dhe se duhet të vendosen dy stenta, njëra stendë është vendosur në atë natë ndërsa tjera ditën e nesërme, mirëpo gjendja e tij shëndetësore veç se është keqësuar, ka qëndruar dy netë në spital dhe është liruar, pasi që na kanë propozuar “D...”ët. Pasi që është dërguar në shtëpi gjendja e tij shëndetësore nuk ka qenë e mirë dhe e kemi dërguar në emergjencën e Gjilanit, prej aty e kemi dërguar në emergjencë në Prishtinë, në Prishtinë kanë thënë që prapë të dërgohet në “I.1...” pasi që të njëjtit e din gjendjen pasi që aty ka vendosur stentat, nga aty kemi dërguar prapë në “I.1...”, aty thanë se të njëjtit u janë bllokuar damarët e zemrës dhe pas një ore i njëjti ka ndërruar jetë. Mjeku që ka vendosur stentat bashkëshortit është S.H.E dhe nuk e di nëse i është bërë obduksioni sepse pasi që ka vdekur unë nuk kam qëndruar

në spital. Tutje ka deklaruar se ka dyshuar se bashkëshortit nuk i janë vendosur stenta dhe e ndjej vetën të dëmtuar në këtë rast.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.10.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar M.V, i cili ka deklaruar se: në muajin Maj të vitit 2010 ka pasur probleme me zemër, dhe nga emergjenca e kanë dërguar në spitalin E... Në atë spital i ka vendosur gjithsej katër stenta, operimin e ka realizuar “D...” L. dhe një “D...” maqedonas, kontrollet kanë përfunduar me datë 06.10.2011.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.10.2024, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar N.M, e cila ka deklaruar se: mbetem pranë deklaratës së dhënë në prokuroi me datën 30.10.2014 në të cilën deklaratë ka deklaruar se me datë 29.09.2014 vëllai B. e ka dërguar babain në QKUK pasi që i njëjti është ankuar për dhimbje të forta në gjoks, për shkak se në QKUK nuk ka pasur mundësi që të realizohet koronografia, ambulanca e spitalit I... e dërguan në spitalin I... për arsye se aty të i bëhet koronografia. Të nesërmen në mëngjes “D...”i M.Q pasi që ka shikuar CD e koronografisë tha se duhet të i vendosen katër stenta e ndoshta edhe pesë stenta, ku ata kërkuan rreth 12.000.00 euro, mirëpo pasi që një i afërm është njohur me M.Q zbriten çmimin në 9.600.00 euro dhe u pajtuam që të i vendosen stentat, mirëpo pas kontaktit me “D...”eshën A.B në QKUK e cila na rekomandoj që një herë të i vendosen vetëm dy stenta për këtë u pajtua edhe “D...”i M.Q dhe çmimi të ishte 3.850.00 euro, pas dy dite babai është liruar nga spitali dhe vëllai ka kryer pagesën. Pas daljes nga spitali gjendja shëndetsore e babit keqësohej, mirëpo mendonim se kjo ishte normale. Për gjendjen e keqe të babait e kemi telefonuar spitalin I... dhe të njëjtit thanë ta dërgojmë babain në QKUK, mirëpo ne e kemi telefonuar ambulancën e Fushë Kosovës dhe ka ardhur ekipi i mjekëve në shtëpi, të cilët vetëm kanë konstatuar vdekjen e babit dhe në të njëjtën datë i njëjti është varrosur dhe nuk i është bërë obduksioni dhe në këtë rast e ndjejmë vetën të dëmtuar.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.10.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar SH.A, i cili ka deklaruar se: mbetem pranë deklaratës së dhënë në prokuroi me datën 06.11.2014 në të cilën deklaratë ka deklaruar se në vitin 2012 babai ka pasur probleme me zemër, fillimisht e kam dërguar në QKUK, pastaj me rekomandimin e “D...” M.G e kam dërguar në spitalin E..., në spitalin E... i kanë vendosur dy stenta “D...”i ka qenë maqedonase mirëpo emri nuk i kujtohet i cili ka thënë se stenat e vendosura kanë garancion pesë vite, për të cilat ka paguar 7.500.00 euro. Pas një viti i njëjti ka pas probleme prape me zemër dhe në QKUK pas kontrolleve kanë

thëne se stentat janë të mbyllura edhe pse për të njëjtat ka pasur garancion pesë vite, pastaj i njëjti është paraqitur në spitalin E... duke ju thëne se për mbylljen e stentave duhet të mbaj përgjegjësi dikush, “D...”i B.D në QKUK tha se tek prindi duhet të intervenohet me Bay pass dhe kjo ishte dashtë të bëhej që në fillim, mirëpo pas operacionit i njëjti ndërroj jetë dhe nuk i është bërë obduksioni, tutje deklaroi se lidhur me rastin e ndjejmë veten të dëmtuar.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.10.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar L.B, i cili ka deklaruar se: mbesim pranë deklaratës së dhënë ne prokuroi me datë 31.10.2014 në të cilën ka deklaruar se në muajin Shtator të vitit 2013 e kemi dërguar nënën në Spitalin e Mitrovicës dhe pas bërjes së EKG, “D...” Merdi Strana tha se duhet dërguar në spitalin turk. Në spitalin turk thanë se duhet të i vendosen dy stenda, mirëpo si fillim duhet të i vendoset një stendë, “D...”ët thanë se operacioni pati sukses dhe brenda sallës ishte një mjek turk i shkurtër me trup. Me datë 02.10.2013 nëna përsëri ka pasur një sulm dhe kam dërguar në spitalin e Mitrovicës, ku ka qëndruar deri me datën 17 tetor mirëpo atë ditë ka pasur përsëri sulm dhe kam kontaktuar me spitalin turk dhe ata me thanë ta dërgomë në Prishtinë. Në Prishtinë ishte “D...”i turk i cili i ka vendosur stenten herën e parë dhe pasi që e bëri koronografinë tha se stenda ju ka mbyllur dhe faji është i joni, se nuk ja kemi vendosur stenten mirë dhe tani duhet me hap përsëri stenten me balon se ju ka mbyllur tutje ka deklaruar se datën kur nëna ka pasur intervenimin, diku në ora 23:00 më kanë thirr nga spitali turk dhe thanë se nënës ju është keqësuar gjendja dhe me datë 20.10.2013 ka ndërruar jetë, po ashtu deklaroi se e ndjejmë veten të dëmtuar, deklaroi se nënës nuk na kanë thënë se duhet të i bëhet autopsia dhe nuk i është bërë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 06.02.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar SH.M, i cili ka deklaruar se: mbesim pranë deklaratës së dhënë ne prokuroi me datë 03.12.2014 në të cilën ka deklaruar se në muajin Shtator të vitit 2011 bashkëshortja ime e ndjere ka pasur problem me zemër dhe pas rekomandimit të “D...”it M.G, e kam dërguar në spitalin E... dhe i janë vendosur dy stenta nga një “D...” maqedonas, për të cilat kam paguar 4000 euro, ndërsa spitali E... që kërkonin edhe 1000 euro të cilat nuk i kisha. Pas shtatë ditësh lirim nga spitali gruaja përsëri kishte probleme dhe jam drejtuar në QKUK dhe të njëjtit prape më kanë udhëzuar në spitalin E..., dhe mjeku maqedonas tha se duhet të i vendosen së paku edhe dy stenta dhe të njëjtat ju vendosen. Pas dy ditësh e kanë telefonuar nga spitali E... dhe thanë se gruaja ju është keqësuar gjendja dhe kur kam shkuar në spital gruaja veç se kishte ndërruar jetë dhe nuk i është bërë obduksioni, tutje deklaroi se e ndjejmë veten të dëmtuar dhe të thyer moralisht pasi që dyshoj se shkak i vdekjes ka qenë gabimet e mjekëve apo mos kujdesit të personelit mjekësor.

Gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar deklaratën e dëshmitarit I.A, të dhënë në prokurori me datë 12.11.2014, i cili ka deklaruar se: në vitin 2012 e ka pasur babain e tij B.G të sëmurë dhe e ka dërguar për trajtim në klinikën e kardiologjisë në QKUK në Prishtinë, aty ka qenë një mjek me emrin Dr. M.G ku të njëjtin e ka takuar dhe ka biseduar lidhur me rastin e babit të tij, ku i ka thënë se në të shtetit nuk ka kushte për vendosjen e stentave dhe duhet të dërgoj babin në spital privat me emrin E..., ku Dr. M.G e ka thirr me telefon spitalin privat E... dhe ju ka thënë se tani po ju dërgoj një pacientë dhe do ti bashkëngjitem këtij intervenim, kur kemi mbërri në klinikën private E..., babait ju kanë bërë incizime dhe analiza, kemi bërë pagesën në shumën 500 euro, pastaj ka ardh Dr. B.Z, i cili na tha se babai i juaj ka nevojë për vendosjen e dy stentave dhe çmimi i tyre kushton 4,500 euro me ilaçe dhe e kam paguar këtë shumë, pas tri ditëve babin tim e lëshuan nga spitali, ku i njëjti prapë ka pas probleme me zemër, e kam dërguar prapë në klinikën e kardiologjisë ku një "D..." emri i të cilit nuk më kujtohet më tha se gjendja e babait nuk është aspak e mirë dhe kontaktova prapë me Dr. M.G dhe e kam dërguar në klinik private tek ai, kur më tha se lej tjerët çka folin gjendja e babit tuaj është e mirë. Po ashtu për këtë gjendje e njoftova edhe mjekun Dr. B.Z, ai më njëfarë mënyre më refuzoi duke thënë se babain duhet ta sjellës për kontroll të rregullt tek unë, pasi që gjendja shëndetësore e babit tim nuk u përmisua e kam dërguar prapë në klinikën e kardiologjisë dhe të neurologjisë, ku ishte prezentë Dr. V.B dhe kërkova sqarim nga ai, i cili më tha se babai juaj ka pas sulm në tru, i cili problem ka ardh nga problemi me zemër dhe ma datën 08.02.2012 i njëjti ka ndërruar jetë. Tutje ka shtuar se parashtron kompensim demi, pasi që e ndjejnë vetën të dëmtuar dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar deklaratën e dëshmitarit M.I, të dhënë në prokurori me datë 03.12.2014, i cili ka deklaruar se: në qershor të vitit 2010 e kam dërguar babin F.I në QKUK, aty ka pas një sulum kardiak dhe vdekje klinike tri herë brenda kohës sa ishëm në spital, një mjek që ka qenë aty më ka orientu në spitalin privat E..., ku kemi shku aty një motër medicinale më ka thënë se mjeku ka thënë se duhet të i siguroni 3000 euro, në të kundërtën nuk intervenojmë te pacienti, pastaj i kemi siguruar ato të holla dhe mjeket i kanë vendosur stenta, një mjek maqedon që emri nuk më kujtohet na ka thanë se operacioni shkoj me sukses, aty e kanë mbajit prindin rreth 12 ditë, pastaj na kanë thanë dërgone në Qkuk se aty e kanë prur një aparatura moderne dhe do ti ndihmoj pacientit, aty mjeket vetëm i kanë dhënë medikamente dhe nuk e kanë futur në asnjë lloj aparati dhe të njëjtën natë ka ndërruar jetë, obduksioni nuk i'u është bërë. Mendoj se prindi nuk ka marr trajtim të duhur në spitalin E..., qëllimi i tyre ka qenë vetëm të i

marrin të hollat dhe arsyeja pse më kanë thanë dërgone prapë në spital të shtetit ka qenë që e kanë ditë se prindi nuk do të jeton gjatë, dhe nuk kanë deshtë që të vdes në spitalin e tyre.

Gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar deklaratën e dëshmitarit R.B, të dhënë në prokurori me datë 22.10.2014, i cili ka deklaruar se: e kishte dërguar motrën e tij L.H në spitalin e Pejës, të njëjtit e kishin udhëzuar për në QKUK, pas bisedës që kishte pas një person në spital e kishte udhëzuar që të dërgojnë në spitalin privat E..., ku aty ju kishin vendosur 2 stenta dhe kishte paguar shumën prej 8000 euro, kur kishte marr analizat e gjakut dhe të urinës kishte vëretjur se motrës së tij ju kishin ngritur vlerat e kreatinës dhe kaliumit, ku ju kishte keqësuar gjendja e veshakëve dhe për këtë e kishte njoftuar një mjek maqedon, të nesërmen kishin shkuar në spitalin E... dhe gjendja e motrës së tij ju ka keqësuar dhe mjekët i kanë thënë se nuk mund të bëjmë asgjë. Për këtë arsye e kishte dërguar motrën e tij në spitalin Pejës për dializë dhe të nesërmen kishte ndërruar jetë. Tutje ka shtuar se parashtron kompensim demi, pasi që e ndjejnë vetën të dëmtuar dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar deklaratën e dëshmitares S.A, të dhënë në prokurori me datë 11.11.2014, e cila ka deklaruar se: bashkëshorti i saj T.A ka kërkuar ndihmë mjekësore fillimisht në ordinancën e mjekut D.Mt i cili pohon se i ka thënë se duhet të shkojë në spital në Mitrovicë, ashtu edhe ka vepruar, në Spitalin Regjional në Mitrovicë kishte qëndruar pesë ditë, aty i janë bërë ekzaminimet e duhura, siç pohon dëshmitarja është trajtuar në mënyrë profesionale pa asnjë vërejtje dhe meqë ka qenë shumë i sëmurë mjeku D.M e kishte udhëzuar për në spitalin turk, meqë i kishte thënë se në QKUK nuk mund t'ju garantojë , ndërsa meqë nuk ka patur rrugëdalje tjetër e kemi dërguar në spitalin I..., me ndihmë të shpejtë, aty i kanë thënë se iu kanë bllokur damarët e zemrës, ia kanë vu dy stenta për të cilat kanë paguar shumën prej 4.000 euro, dhe pastaj pas dy dite të daljes nga spitali, është dashur të dergohet përseri në spitalin turk ku edhe ka ndërruar jetë. Më tutje ka shtuar se e konsideron vetën palë të dëmtuar dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar deklaratën e dëshmitarit A.S, të dhënë në prokurori me datë 29.10.2014, i cili ka deklaruar se: babi im H.S në gusht të vitit 2013 kishte pas probleme me zemër dhe e kam dërguar në Qkuk, aty mjeku N.Z me tha se babain duhet me dergu në spitalin privat E... dhe unë e kam dërguar ku atje me thanë se duhet me ju bë një koronografi për me ditë a duhet me ju vendos stentat dhe ata nuk më kishin pyetur fare dhe e kishin vendosur në sall dhe dolën më thanë ja vendosur stentat dhe më pas babi ndërroj jetë, unë kisha paguar 700 euro për

koronografi, ndërsa të spitalit mi kërkonin edhe 4,000 euro për stenta, por të njëjtëve nuk i'a dhashë pasi më vdiq babai, ata na thanë se nuk e lëshojmë trupin e babait pa ja paguar parat, kështu që paguam edhe 1,000 euro, obduksioni nuk i'u është bërë. Tutje ka shtuar se parashtron kompensim demi, pasi që e ndjejnë vetën të dëmtuar dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar deklaratën e dëshmitares A.K.G, të dhënë në prokurori me datë 17.03.2016, e cila ka deklaruar se: me datë 26.01.2013 babai im SH.K ka pas probleme me shëndet dhe e kemi dërguar në emergjencë në Qkuk dhe pas kontrolleve mjekësore nga Dr. N.Z, i njëjti na tha se nuk është në gjendje të mirë shëndetësore dhe duhet vendosur stenta babait tim dhe i vetmi shpëtim është që të dërgoni në spitalin privat E..., ku edhe e kemi dërguar atje na ka pritur një mjek maqedon emrin e të cilit nuk ja di, i cili na tha se duhet ti bëhet koronografi dhe ti vendosen stenta, për të cilat udhët të paguhet shuma prej 3,660 euro, pas intervenimit kirurgjik i njëjti është dërguar në intensiv, ku mjeku maqedon na njoftoi se zemra është e dobët dhe nuk mund të funksionoi dhe babi ka ndërruar jetë, obduksioni nuk ju është bërë babit, dajt e ka mi e kanë nënshkruar dokumentin që nuk kemi deshtë të bëjmë obduksion, pasi që atyre i kanë thënë që ky dokument është që po e tërheqin trupin e pa jetë nga spitali, dhe nuk e kanë ditur çfarë janë duke nënshkruar. Tutje ka shtuar se parashtron kompensim demi, pasi që e ndjejnë vetën të dëmtuar dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar deklaratën e dëshmitares M.M, të dhënë në prokurori me datë 26.01.2016, e cila ka deklaruar se: në vitin 2013 pasi që nëna ime K.K nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore, e kam dërguar në Qkuk dhe mjeku kujdestar të cilit emrin nuk ja di, por kishte qenë pa flokë dhe i gjatë, i njëjti pa e kontrolluar fare nënën më ka thënë nëse doni të shpëtoni nënën tuaj duhet të dërgoni në spitalin privat E..., pasi që kemi arritur në atë spital një mjek me emrin S... na ka thënë se menjëherë duhet të operohet nëna, ku do ti vendoset një aparat afër zembrës, ku për këtë kemi paguar shumën prej 4,800 euro, dy netë kishte qëndruar në spital, ndërsa pas pesë ditëve që u operua ka pasur problem me këmbë deri tek gjunjët dhe përsëri e dërgova te mjeku S..., i cili tha se janë shenja të kancerit të lëkurës, ndërsa kur e kemi pyetur një mjek nga spitali Kavaja, ai na tha se këto shenja janë që salla ku është operuar nëna nuk ka qenë e sterilizuar dhe është infektuar dhe me datën 14.03.2013 ka ndërruar jetë. Tutje ka shtuar se parashtron kompensim demi, pasi që e ndjejnë vetën të dëmtuar dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar deklaratën e dëshmitarit N.A, të dhënë në prokurori me datë 29.10.2014, i cili ka deklaruar se: nëna ime SH.A ka pasur probleme në muajin Prill 2013 dhe është dërguar në kardiologji, ku i'u është bërë koronografia dhe është vërejtur se ka nevojë për stenta, mirëpo na kanë thënë se kjo nuk mund të bëhet në Qkuk dhe e kemi dërguar tek një spital privat I..., ku aty është pranuar nga mjeku M.Ç, i cili na ka thënë se nënës duhet vendosur tri stenta, edhe pse ne nuk ishëm të pajtimit që ti vendosen ato, Dr. M... insistojke që ti vendosen të njëjtat, nëna është përgaditur për operacion në ora 9 të mëngjesit dhe ka qëndruar pa ngrënë asgjë dhe pothuajse e zhveshur deri në ora 8 në mbrëmje, përkundër insistimit tonë të kuptojm pse po ndodhë kjo zvarritje, të njëjtit na thoni se tani do të kryhet. Pas vendosje së stentave Dr. M... nga ka ftuar në zyre dhe na ka thënë se çdo gjë ka shkuar mirë, në atë moment ka ardhë dikush nga personeli mjekësor dhe e ka njoftuar "D..."in se gjendja e pacientes është përkeqësuar, diku pas 40 minutave jemi shkuar te nëna dhe na tha e pata një dhimbje të madhe në gjoks dhe mu dukë se ika nga kjo botë, pro "D..." i na thoshte se mos u bëni merak se nëna do të lirohet nesër nga spitali, nëna ime ka patur probleme me mushkri, ndërsa pas vendosjes së stentave brohitizi kishte kaluar me një shkallë më të lartë. Pas lëshimit nga spitali Dr. M... na tha se duhet ta sillni për vizitë me datën 18.11.2013 në të njëjtin spital, mirëpo një ditë më herët ajo kishte ndërruar jetë. Tutje ka shtuar se parashton kompensim demi, pasi që e ndjejnë vetën të dëmtuar dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar deklaratën e dëshmitarit N.P, të dhënë në prokurori me datë 10.11.2014, i cili ka deklaruar se: me datën 25.10.2024 babi im N.P është sëmur dhe me udhëzim të spitalit të Mitrovicës e kam dërguar në Qkuk, ku është pranuar mjeku Dr. N.Z dhe pas EKG-së më ka thënë se ai nuk mund ët bëjë asgjë dhe babi mund të jetoj më shë shumti 3 orë dhe duhet të deëgoni në spitalin E..., pas dërgimit në këtë spital të njëjtin e pranuan dy mjekë, njëri Maqedon e tjetri Shqiptar, këta mjek më thanë se duhet ti vendosur dy stenta dhe të bëhet koronografia, dhe mi kanë kërkuar 4,000 euro, ku përfshi qëndrimi në spital për dy ditë, unë i kam paguar 700 euro për koronografi, dhe 130 euro të nesrit dhe ju kam thënë se paratë tjera do të ju sjelli më vonë, të njëjti më kanë thënë se nuk e n'shojm pacientin pa u paguar e gjithë shumë, meqenëse babai im vdiq nesër une vendosa të mos e paguaj shumën tjetër prej 2,000 euro, të njëjtit më thanë se babai ka vdekur pasi që kishte pasur një sulm dhe kishte problem me mushkri, të njëjtit nuk i'u është bërë obduksioni, ata na kanë thënë nënshkruani që po e merrni kufomën, e që nuk e kemi ditur që po nënshkruajmë që të mos i bëhet obduksioni. Tutje ka shtuar se parashton kompensim demi, pasi që e ndjejnë vetën të dëmtuar dhe i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Nga Udhëzimi Administrativ nr.08/2007 për ofrimin e Shërbimeve Spitalore në Kosovë, janë të parapara kushtet e përgjithshëm që duhet të ofrohen shërbime, siç janë kushtet e ambientit, objektit, radhitja e hapësirave spitalore, pajisjet dhe inventari, shërbimi administratës për spitalet etj.

Nga Dosjet e pacientëve, të Ministrisë së Shëndetësisë për pagesat e shpenzimeve të trajtimit mjekësor në I... dhe E..., vërtetohen pagesat që janë bërë në emër të pacientëve për trajtimin e tyre, që e kanë bërë në këto dy spitale private.

Nga Raporti i spitalit privat I... -së nr.4285 të datës 16.07.2014, vërtetohet se në kardiokirurgji rezulton se vetëm për periudhën 2010-2014 kanë vdekur 49 persona, ndërsa kardiologji invazive kishin vdekur 104 persona.

Nga Raporti i spitalit privat E... nr.50/2014 të datës 08.09.2014, vërtetohet se vetëm për periudhën 2009-2014, rezulton se kishin vdekur 67 persona.

Nga Raporti nr. Ref.10/H-074-13 i datës 22.10.2013 i inspektimit specifik të Inspektionit Shëndetësor (ISH), vërtetohet se Inspeksioni Shëndetësorë kishte rekomanduar ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë shëndetësore të spitalit E... deri në licencimin pranë MSH-së dhe plotësimin e kushteve të parapara me aktet ligjore në fuqi.

Nga Raporti Ref.nr.No.10/D-070-13 i datës 24.10.2013, vërtetohet se spitalit I... i ndalohej ofrimi i shërbimeve shëndetësore në fushën e laboratorit hematologjik deri në licencim pranë Ministrisë së shëndetësisë.

Nga Raporti i inspektionit shëndetësor i përpiluar me datë 09.10.2014, vërtetohet se spitali privat "I.2..." - E... edhe pas skadimit të licencës me datë 03.06.2014 kishte punuar pa licencë deri më datë 22.08.2014.

Nga Raporti i BQRL-së i datës 30.10.2013 i nënshkruar nga Kryesues Hysni Bajrami, vërtetohet se sipas kërkesës së spitalit privat "I.2...", e njëjta për herë të parë ka aplikuar për licencë në vitin 2007 dhe nuk ishte licencuar, pas nxjerrjes së vendimit nga MSH me datë 04.01.2008 komisioni vendosi që t'i lejoj angazhimin e Dr. B.P deri në mars të vitit 2008.

Nga Vendimi nr.10/R-23-13 i datës 28.10.2013 i Inspektoratit shëndetësor, vërtetohet se mjekëve që vinin nga Republika e Maqedonisë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës i ishte ndaluar ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore.

Nga Vendimi Nr.10/R-22-13 i datës 28.10.2013 i Inspektoratit shëndetësor, vërtetohet se disa nga mjekëve maqedon, përfshirë edhe të pandehurin B.P i ndalohet ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, deri në licencim nga Ministria e Shëndetësisë.

Nga Procesverbali nr.004945 të dt.09.10.2014 i Inspektoratit shëndetësor, vërtetohet se nga data 02.06.2014, spitali privat E... kishte ushtruar veprimtarin shëndetësore pa licencë pune nga data 02.06.2014 deri me datën 22.08.2014, ashtu që ishte pezulluar përkohësisht veprimtaria e punës e të njëjtës.

Nga Raporti i Policisë së Kosovës nr.06/03-267/15 të datës 03.08.2015 të cilit i janë bashkangjitur edhe përgjigjja e Departamentit për zhvillim strategjik shëndetësor të MSH-së me numër 05-2731 i datës 21.05.2015 lidhur me spitalin E... dhe përgjigjja e të njëjtit departament me nr. të protokollit 05-2961, vërtetohet se në të njëjtën është konstatuar se nga udhëheqësi i Divizionit për Licencim dhe Akreditim të Institucioneve Shëndetësore pranë Ministrisë së Shëndetësisë, për spitalin “I.2...” E... me datë 29.10.2014 është nxjerrë vendim për pezullim të veprimtarisë së të njëjtit për shkak të mungesës së stafit për ofrimin e shërbimeve për të cilat është licencuar, ndërsa që me datë 29.01.2015 Bordi për Licencim të Institucioneve Private Shëndetësore ka shfuqizuar vendimin për pezullim

Nga Përgjigjja për interpretim ligjor të lëshuar me datë 12.11.2013 me nr. 189/2013 nga Komisioni rregullativ i prokurimit publik, vërtetohet se nga Komisioni rregullativ i prokurimit publik, në të cilën konstatohet se MSH është autoritet kontraktues siç përkufizohet në nenin 4 par 1 nënpar 1.13 të ligjit për prokurim publik dhe si autoritet kontraktues është i obliguar t’i zbatojë dhe t’i respektojë kërkesat e këtij ligji si dhe fondet dhe burimet publike, fondet dhe burimet tjera t’i shfrytëzojë në mënyrë efikase, transparente dhe të drejtë.

Nga Përgjigjja e Ministrisë së Shëndetësisë – Departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme që mbanë numrin 08 nr.05-930/2 i dt.16.03.2016, të cilit i janë bashkangjitur të

dhënat për pagesat e shërbimeve mjekësore të ofruara për pacientët në spitalet private I... dhe E..., vërtetohet se letrat referuese si urdhër obligim për pagesat të lëshuara nga të akuzuarit, dhe shihet lista e emrave të mjekëve që i'u është bërë pagesa dhe kanë marrë para në emër të referimit të pacientëve në I...-së.

Nga Raporti i bastisjes i datës 09.10.2014, lidhur me bastisjen e spitalit privat I..., dhe të pandehurit A.H, vërtetohet se nga zyra e drejtorit të këtij spitali A.H janë marrë dokumente prej 64 faqeve dhe 5 fletore të punës, po ashtu janë marrë një dosje me 78 fletë, një Llap top i tipit Acer ngjyrë hiri me adapter dhe një shtëpizë kompjuteri Compach.

Nga Raporti i bastisjes i dt.09.10.2014, lidhur me bastisjen e spitalit privat "I.2..." dhe zyrave të të pandehurve L.B dhe B.P, vërtetohet se janë marrë një fletore ngjyrë portokalli, një orar i kujdestarisë, dy kartela financiare për periudhën 12.12.2009 deri më 22.09.2014, një raport mjekësor për vdekje, dy Fletë "I.2..." shpk dt.14.01.2014, një përgjigje lidhur me kërkesën për licencim-subspecializim, protokollin 05/11 i datës 22.03.2011, përgjegjen e kërkesës dt.28.08.2009, Vendimi i dt. 28.10.2013, lista e punëtorëve shëndetësor datë 09.10.2014, fletore e B.Pt, protokollin i të sëmurve nr.3, katër fletore të kujdestarive dhe një shtëpizë e kompjuterit.

Nga Raporti i ekspertizës për ekzaminimin e kompjuterëve të sekuestruar nga spitali privat I... nr. AKF-2014-0143 dhe E... nr.AKF-2014/0141, që janë paraqitur nga Laboratori për ekzaminim të kompjuterëve i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, vërtetohet se nga Spitali Privat I... dhe Spitali Privat E... janë analizuar këta kompjuter nga eksperti i çështjeve ekonomike në kuadër të Policisë së Kosovës, që rezultojnë me shënimet me emra të mjekëve që kanë punuar në institucione shëndetësore publike dhe shumat e pagesave.

Nga Dy fletoret e sekuestruara në spitalin privat I... dhe atë njëra me ngjyrë të zezë që në kopertinë mbanë shenjën BKT (Banka Kombëtare Tregtare) si dhe një fletore ngjyrë e kaltër e mbylltë në kopertinë e të cilës shkruan Kasa Defteri dhe nga fletorja e sekuestruar në spitalin privat E... që i përkiste të pandehurit B.P, me ngjyrë kafe në kopertinë e të cilës gjendet një tiketë e vendosur me numër 5 dhe shkrimin në çirilic "LIN - IMPEX, vërtetohet se në to ka shënime me emra të ndryshme, me shifra dhe shënime të tjera të pakuptueshme, të mbajtura si shënime personale të kujtdo qoftë për nevoja të spitalit apo pronarit apo edhe dikujt tjetër.

Nga shikimi i CD-të lidhur me ekspertizën e kompjuterëve si dhe fletoret e lartcekura, vërtetohet se sipas kërkesës së prokurorisë speciale është kërkuar që të gjinden disa nga dëshmi si në urdhëresën e prokurorisë dhe pas ekzaminimit janë gjetur një numër i caktuar i dokumenteve, foto imazhe, ndërsa disa tjera nuk janë gjetur sepse kanë qenë të fshira.

Nga Shkresa e spitalit privat “I.2...” - E... me nr.35 të datës 18.01.2016, lidhur më të punësuarit në spitalin E..., vërtetohet se në spitalin E... kanë qenë të punësuar përveç mjekëve të tjerë edhe mjekët që janë objekt i aktgjykimit për kohë të caktuar dhe me gjysmë orari të punës.

Nga Shkresa e spitalit privat I... nr. 6094 të datës 15.01.2016, lidhur më të punësuarit në spitalin I..., vërtetohet se në këtë spital kontratë pune përveç mjekëve të tjerë edhe mjekët që janë objekt i aktgjykimit për kohë të caktuar dhe me gjysmë orari të punës.

Nga Raporti për të dhënat financiare nr.06/03-69/15 të dt.24.02.2015, lidhur me bizneset N.Sh “D...”, vërtetohet se personat që rezultojnë që kanë realizuar paga nga puna e tyre në këtë institucion janë 25 persona, prej të cilëve edhe disa nga të akuzuarit në këtë çështje penale, siç janë: L.B, B.Z, N.Z dhe A.B.2.

Nga Raporti i Policisë së Kosovës për të dhënat financiare të N.sh “D...” nr.06/03-194/15 i datës 02.06.2015, të cilit i është bashkangjitur raporti i datës 19.03.2015, vërtetohen transaksionet që janë bërë nga ky institucion në emër të pagës për të punëtorët që kanë punuar në këtë institucion, në mesin e tyre janë edhe disa nga të akuzuarit në këtë çështje penale, siç janë: L.B, B.Z, N.Z dhe A.B.2.

Nga Raporti i Policisë së Kosovës për të dhënat financiare të Nsh “D...” nr.06/03-271/15 i datës 04.08.2015, vërtetohet qarkullimi bankar dhe analizimi i transaksioneve përmes llogarive bankare që ka realizuar subjekti afarist Nsh “D...”, ku janë paraqitur në mënyrë të strukturuar të gjitha të hyrat dhe daljet e mjeteve monetare.

Nga Raporti i Policisë së Kosovës për të dhënat financiare nr.06/03-272/15 i datës 04.08.2015, të cilit i janë bashkangjitur raportet e datës 03.08.2015, të spitaleve I.. dhe E..., vërtetohet se qarkullimi bankar dhe analizimi i transaksioneve përmes llogarive bankare që ka realizuar subjekti afarist I..., ku janë paraqitur në mënyrë të strukturuar të gjitha të hyrat dhe daljet e mjeteve monetare.

Nga Raporti i Administratës Tatimore të Kosovës NJHTI nr.116/2015 të datës 06.05.2015 sipas të cilit raport rezulton se N.sh “D...”, vërtetohet qarkullimi i deklaruar si dhe tatimi i paguar nga subjektet afariste N.sh “D...” dhe “I.2...” shpk, ku mund të shihet se nga deklarimi i transaksioneve, subjekti N.sh “D...” i ka kryer shërbime subjektit “I.2...” shpk në vlerë prej 377,764.00 euro.

Nga Raporti i Njesisë së Hetimeve Tatimore të ATK-së NJHTI nr.196/2015 i datës 04.08.2015, vërtetohet se nga sistemi Sigtas i ATK-së, të akuzuarit L.B dhe A.H nuk figuron që kanë biznese të regjistruar në emër të tyre, ndërsa i akuzuari B.P figuron që të ketë biznes me emrin Nsh “D...” dhe borxhi total i këtij tatimpaguesi është shuma prej 10,253.35 euro dhe i akuzuari N.Z figuron që të ketë biznes me emrin Nsh “Z...”, qarkullimi nga hapja e këtij biznesi e deri më sot është shuma 480.00 euro (periudha TM2/2015_ dhe borxhi total i këtij tatimpaguesi është shuma prej 118.60 euro

Nga Përgjigjja e Departamentit për zhvillim strategjik shëndetësor të MSH-së me numër të njësisë 05-2381/2 të datës 05.05.2015 për N.sh. “D...” ku shihet se nuk kishin aplikuar asnjëherë për licencim në MSH – Bordin për licencim të institucioneve private shëndetësore, vërtetohet se

Nga Raporti final i departamentit të hetimit tatimor dhe inteligjencës të ATK-së, DHTI nr.120/2016 të dt.28.04.2016 si dhe shkresave të bashkangjitura të këtij raporti, vërtetohet se të akuzuarit N.Z, A.H, B.P dhe L.B bazuar në dosjen finale të hetimit sipas provave të zbuluara, përmes bizneseve të tyre kanë bërë shmangie të tatimit.

Nga Raporti i auditimit të brendshëm për biznesin N.sh ““D...”” për vitet 2012, 2013 dhe 2014 të cilin e ka sjellë në Prokurori vet përpiluesi i këtij raporti Y.SH, vërtetohet se në pjesën që trajtohen subvencione dhe transferet, konstatohet se trajtimi mjekësor në spitalet private do të duhej të bëhej vetëm pas konfirmimit se nuk kishte kushte për trajtim të sëmundjes së institucione publike shëndetësore.

Mbrojtja e të akuzuarve:

Të akuzuarit, në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.10.2024 kanë deklaruar se: do të shfrytëzojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes në heshtje dhe se mbesin pranë deklaratave të tyre të dhëna në Prokurori.

I akuzuari A.H, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 17.05.2016, ka deklaruar se shënimet që janë gjetur në kompjuterin e sekuestruar janë për angazhimin e mjekëve që kemi planifikuar që në të ardhmen të punojmë me ta, me ata që kemi punuar kemi bërë kontratë, ndërsa me ata që nuk kemi punuar nuk kemi bërë kontratë. Emrat e mjekëve që kam mbajte shënime që punojnë në institucione publike, kanë qenë mjekë potencial për të punuar në I..., ky institucion ka pas licencë pune. Familjarët e pacientëve të vdekur kanë qenë kundër që të bëhet obduksioni i tyre.

I akuzuari A.B.1, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 03.11.2014, ka deklaruar se kjo akuzë që më bënë pjesëmarrës në grup kriminal si dhënës i ryshfetit është tepër e rëndë dhe nuk ka bazë ligjore. Raportet e mija me drejtorinë I... janë vetëm në aspektin profesional ku kam punuar në këtë institucion privat, unë jam i gatshëm në çdo rrethanë ti përgjigjem ftesave të organeve të drejtësisë dhe të zbardhët deri në fund ky rast.

I akuzuari B.P, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 14.01.2016 ka deklaruar se nuk kam pasur kompjuter, fletore, çelës të asnjë dollapi personal në klinikën “I.2...”. Të gjithë mjekët që kanë kryer shërbime në “I.2...”, janë paguar përmes bankës në bazë të kontratave dhe asnjëherë nuk janë paguar asnjë mjek vetëm që ka dërguar pacientë në “I.2...”.

I akuzuari L.B, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 16.02.2016, ka deklaruar se pas arrestimit tonë spitali “I.2...” e ka ndërpre punën për një kohë, derisa kemi aplikuar përsëri në muajin shkurt të vitit 2015 dhe kemi punuar deri në Qershor të vitit 2015 ku na është ndërpre puna nga Inspektorati i Shëndetësisë, pas që nuk kishim kardiokirurgji dhe me këtë rast kemi arritur marrëveshje me spitalin Amerikan dhe Inspektorati na ka lejuar prapë që të vazhdojmë punën.

I akuzuari A.B.2, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 16.05.2016, ka deklaruar se në spitalin I... kam punuar si kardiolog nga muaji gusht 2010 deri në muajin dhjetor të vitit 2012 me orar të plotë, në rastet kur unë kam kryer intervenime kirurgjike asnjë pacientë nuk ka vdekur.

I akuzuari D.S, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 17.03.2016, ka deklaruar se do të shfrytëzoj të drejtën e tij të mbrojtjes në heshtje, ndërsa në polici me datë 20.01.2015 ka deklaruar se unë nuk i kam rregulluar dokumentet e pacienteve për aplikim për pagesë të

referuara nga QKUK në spitalin I..., po ashtu nuk i kam dhënë të holla mjekëve që kanë referuar pacientë në I....

I akuzuari A.T, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 12.05.2016, ka deklaruar se do të shfrytëzoj të drejtën e tij të mbrojtës në heshtje, ndërsa në polici me datë 02.10.2015 ka deklaruar detyra ime në spitalin I... ka qenë përgjegjës për financa, të gjitha pagesat që janë bërë në këtë institucion janë bërë përmes transferove bankare.

I akuzuari M.Q, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 20.04.2016, ka deklaruar se në spitalin I... kam punuar si kardiolog në fushën invazive nga muaji Gusht 2010 me orar jo të plotë. Nuk është e vërtetë ajo se çfarë kanë deklaruar dëshmitarët se unë ju kam vendosur by pass-at dhe se ju kam thënë se duhet të i mbledhin paret brenda 24 h se përndryshe mund të mbetni në karrocë për shkak të sulmit në kokë.

I akuzuari SH.E, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 11.05.2016, ka deklaruar se në spitalin I... kam punuar nga viti 2009 deri në fillim të vitit 2014 si kardiolog invaziv, ka pasur raste që pas vendosjes së stentave dhe pas kryerjes së koronografisë të kenë vdekur pacientet. Lidhur me obduksionin ka qenë përgjegjësi e menagjmentit që të merren me atë pjesë dhe nuk jam në dijeni se si kanë vepruar.

I akuzuari B.Z, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 16.03.2016, ka deklaruar se unë kam qenë duke punuar më herët në spitalin "I.2..." E..., ku drejtor ka qenë L.B, ku kam pasur kontratë pune dhe pagesa më është bërë përmes llogarisë bankare. Unë nuk kam bërë intervenime invazive por vetëm ekzaminime jo invazive.

I akuzuari R.Q, në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 16.03.2016, ka deklaruar se unë jam kirurg kardiovaskular dhe punoj në QKUK si drejtor i shërbimit kardiokirurgjik, me spitalin E... nuk kam kurrfarë marrëdhënie dhe nuk e kam referuar asnjë pacientë në këtë spital që të shkoj nga QKUK në I.... Unë kam punuar në I... rreth dy viteve përderisa të njëjtit vendosen të më ndërprerjen marrëdhënien e punës, për shkak se unë nuk kam pranuar që të punoj sipas rregullave të tyre.

Vlerësimi i Gjykatës:

Faktet jo kontestuese:

Nga të gjitha provat materiale dhe personale të administruara si më lartë, për gjykatën nuk është kontestuese fakti se personat e akuzuar kanë punuar në spitale private dhe shtetërore, nuk është kontestuese se personat e dëmtuar kanë marr trajtim mjekësor nga tani të akuzuarit, përjashtimisht të akuzuarit A.H i cili asnjëherë nuk ka qenë me profesion mjekë por vetëm menagjer - ekonomist, nuk është kontestuese se disa nga personat, siç janë: I.B, M.D, K.M, A.A, A.B, H.M, B.G, F.I, L.H.XH, T.A, H.S, SH.K, K.K, SH.A dhe N.P, pasi që kanë marr trajtim mjekësor më pastaj kanë vdekur. Po ashtu nuk është kontestuese fakti se për vdekjen e këtyre personave nuk është bërë obduksioni, përveç të ndjerit I.B, të cilit i'u është bërë obduksioni dhe është konstatuar se vdekja e tij ka qenë natyrore.

Faktet e lartcekura nuk kanë qenë kontestuese në mes të palëve. Përveç kësaj, faktet e tilla vërtetohen edhe nga dëshmitë e të dëmtuarve - dëshmitarëve dhe provave materiale.

Faktet kontestuese:

Për gjykatën kontestuese ishte fakti nëse nga trajtimi mjekësor i dhënë nga të akuzuarit: A.H, M.Q, SH.E, R.Q, A.B.2, "I.1..." sh.p.k - (person juridik) dhe "I.2..." sh.p.k - (person juridik), ka ardhë deri tek vdekja e personave të ndjerë të cilët kanë shkuar për trajtim tek të njëjtit, po ashtu kontestuese ka qenë fakti se nëse të akuzuarit: A.H, A.B.1, A.T, D.S, A.B.2, L.B, B.P, "I.1..." sh.p.k - (person juridik), "I.2..." sh.p.k - (person juridik) dhe N.SH. "D..." - (person juridik) kanë dhënë ryshfet dhe kujt i kanë dhënë ryshfetë, gjithashtu kontestuese ishte fakti se nëse të akuzuarit: A.H dhe "I.1..." sh.p.k - (person juridik), L.B, "I.2..." sh.p.k - (person juridik), B.P, N.SH. "D..." - (person juridik), N.Z dhe NSH. "Z..." - (person juridik) kanë bërë shmangie nga tatimi me rastin e ushtrimit të veprimtarisë mjekësor me bizneset e tyre.

Faktet kontestuese gjykata i ka zgjidhur pas administrimit të provave materiale dhe personale gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe analizimit të elementeve të veprës penale për të cilën akuzohet i akuzuari.

Pas të gjitha provave personale dhe materiale të administruar gjatë shqyrtim gjyqësor, gjykata vlerësoi se nuk janë përmbushur elementet e veprave penale për të cilat të akuzuarit janë akuzuar sipas aktakuzës së prokurorisë. Nga të gjitha këto rrethana për gjykatën rezulton se provat qe mbështesin aktakuzën nuk krijohet dyshimin i bazuar mirë për elementet e veprave penale për te cilën akuzohen të akuzuarit, më saktësisht me asnjë provë që prokuroria e mbështet aktakuzën

nuk rezulton se të njëjtit me veprimet e tyre i kanë konsumuar elementet e veprave penale për të cilat akuzohen.

Ashtu që gjykata pas vlerësimit me ndërgjegje të provave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjykata vlerëson se pas administrimit të provave të administruar është vërtetuar gjendja faktik, mirëpo nuk janë përmbushur asnjëri nga elementet e veprave penale.

Gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarve: A.H, A.B.1, A.T, D.S, A.B.2, L.B, B.P, “I.1...” sh.p.k - (person juridik), “I.2...” sh.p.k - (person juridik) dhe N.SH. “D...” - (person juridik) nuk përmbushën elementet e veprës penale në bashkëkryerje Dhënie e ryshfetit nga neni 429 par.2 dhe 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që në par.2 të këtij neni thuhet se *“Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet”,* ndërsa në par.3 të këtij neni thuhet se *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”.*

Gjykata ka vlerësuar këtë dispozitë ligjore, ku ka konstatuar se me vetë faktin se personat të cilët janë dyshuar se kanë marrë ryshfete nga këtu të akuzuarit: A.H, A.B.1, A.T, D.S, A.B.2, L.B, B.P, “I.1...” sh.p.k - (person juridik), “I.2...” sh.p.k - (person juridik) dhe N.SH. “D...” - (person juridik), e të cilët kanë qenë të akuzuar dhe njoftur në rastin e njohur në rastin Stenta II dhe IV, e të njëjti janë liruar nga akuza në mungesë të provave, gjykata vlerëson se nuk mund të ketë dhënie ryshfeti pa u vërtetuar fakti se kush është marrësi, nga provat e administruar në këtë shqyrtim gjyqësor, në asnjë moment nuk është vërtetuar se kush është marrësi i ryshfetit lidhur me këto pika të akuzës, aktakuza e prokurorit të shteti ka qenë vetëm parafrazim i dispozitave ligjore, duke mos e mbështetur me asnjë provë të vetme.

Gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarve: A.H, M.Q, SH.E, R.Q, A.B.2, L.B, B.P, B.Z, “I.1...” sh.p.k - I... - (person juridik) dhe “I.2...” sh.p.k - E... - (person juridik) nuk përmbushën elementet e veprës penale në bashkëkryerje Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.1 dhe 4 lidhur më nenin 31 të KPRK-së, pasi që në par.1 të këtij neni thuhet se *“Mjeku i cili me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore përdor haptas një mjet apo metodë të papërshtatshme të mjekimit ose nuk përdor masat përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes*

shëndetësore të personit, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet”, ndërsa në par.4 të këtij neni thuhet se “Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dymbëdhjetë (12) vjet”.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese gjendja faktike se disa persona siç janë: I.B, M.D, K.M, A.A, A.B, H.M, B.G, F.I, L.H.XH, T.A, H.S, SH.K, K.K, SH.A dhe N.P, kanë kërkuar trajtim mjekësor nga të akuzuarit dhe të njëjtit pas marrjes së trajtimit mjekësor kanë ndërruar jetë, e për të cilët nuk është bërë obduksioni me përjashtim të ndjerit I.B, të cilit i’u është bërë obduksioni dhe është konstatuar se vdekja e tij ka qenë natyrore, si dhe disa personave ju janë vendosur stenta. Gjykata vlerëson se nga të gjitha provat si ato materiale si ato personale të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor nuk janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale trajtimi i pa ndërgjegjshëm mjekësor pasi që për tu përmbushur ky element i veprës penale, sëpari personi i cili akuzohet duhet të jetë mjekë, e që në rastin konkret i akuzuari A.H, me profesion është ekonomist dhe nuk vërtetuar se i njëjti ka ushtruar veprimtari mjekësor, ndërsa për të akuzuarit: M.Q, SH.E, R.Q, A.B.2, L.B, B.P dhe B.Z, për tu përmbushur ky element i veprës penale duhet të përdorën haptazi një mjetë apo metodë e pa përshtatshëm e mjekimit, ose nuk përdor masa përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit, e në rastin konkret, rezulton se metodat e mjekimit janë përdorur sipas standardeve mjekësor, gjithashtu nuk ka prova se ndonjë nga personat e vdekur, si pasojë e mos përdorjes së masave higjienike, andaj vlerësojmë se me asnjë provë të vetme nuk janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale. Ndërsa sa i përketë personave juridik: “I.1...” sh.p.k - I... - (person juridik) dhe “I.2...” sh.p.k - E... - (person juridik), gjykata vlerëson se të njëjtit nuk mund ta kryerjen këtë veprë penale edhe në qoftëse ishin përmbushur të gjitha elementet e kësaj vepre penale, pasi këtë veprë penale mund ta kryerjen vetëm personat përgjegjës të personave juridik.

Gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarve: A.H dhe “I.1...” sh.p.k - (person juridik) nuk përmbushën elementet e veprës penale *Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.3 lidhur më par.1 të KPRK-së*, pasi që në par.3 të këtij neni thuhet se *“Kur detyrimi nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumën prej pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”,* ndërsa në par.1 të këtij neni thuhet se *“Kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t’i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, jep të dhëna të pavërteta apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”.*

Gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarve: L.B, “I.2...” sh.p.k - (person juridik), nuk përmbushën elementet e veprës penale *Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur më par.1 të KPRK-së*, pasi që në par.2 të këtij neni thuhet se *“Kur detyrimi nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumën prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*, ndërsa në par.1 të këtij neni thuhet se *“Kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t’i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, jep të dhëna të pavërteta apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”*.

Gjykata gjen se nga veprimet e të akuzuarve: A.H, “I.1...” sh.p.k - (person juridik), L.B, “I.2...” sh.p.k - (person juridik), nuk janë përmbushur elementet e veprës penale *Shmangie nga tatimi*, pasi që nuk ka ekzistuar asnjë provë e vetme për të vërtetuar këtë vepër penale, konkretisht prokurori i shteti nuk ka dëshmuar se ekziston shmangia e tatimit në këtë rasti, pasi që nuk ka angazhuar ndonjë ekspertizë financiare, nga ekspertet e pavarur me të cilën do të vërtetohet se të akuzuarit kanë bërë shmangie nga tatimi, me rastin e kryerjes së veprimtarisë së tyre mjekësore.

Gjykata vlerësoi pretendimet e Prokurorisë, por e njëjta nuk arriti që t’i argumentoj me fakte dhe prova bindëse para gjykatës elementet e veprave penale me të cilën ngarkohen të akuzuarit, ngase nga provat e administruara nuk u gjet se në veprimet e të akuzuarve formësohen elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprave penale të cilat i’u vihen në barrë sipas aktakuzës, andaj nisur nga të gjitha këto që u thanë më lartë trupi gjykues pasi analizoi provat materiale dhe bazën ligjore, nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarve formësohen elementet e veprave penale si më lartë.

Gjykata ka vlerësuar deklarinimin e të akuzuarve dhënë në prokurori, si të sinqertë dhe të mbështetur në provat materiale dhe personale të cilat janë administruara në shqyrtim gjyqësor dhe si të tilla të njëjtave i’a fali besimin.

Në këtë rast gjykata në aplikim të nenit 3 par.2 të KPRK-së, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite i interpreton në favor të

akuzuarve, e që në rastin konkret të gjitha mëdyshjet e paraqitura në vlerësim të gjendjes faktike e të cilat nuk u vërtetuan përtej dyshimit të bazuar mirë, i mori në favor të akuzuarve.

Gjykata ka shpallur prova të pa pranueshme Urdhëresat e Gjyqtarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate nën shenjën PNKR.482/2013 të datës 20.12.2013 si dhe datës 07.02.2014 me të gjitha traskriptet e përgjimeve të renditura sipas provës materiale me numër rendor 25 dhe 30 të procesverbalit të datës 15.10.2024, sa i përket të pandehurve A.H, L.B, B.P dhe A.B.1. Pasi që aktvendimi për fillimin e hetimeve, prokurori i shteti e ka marr me datë 16.06.2014, ndërsa përgjimet janë lëshuar para kësaj date. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, provat e siguruara përmes masave të fshehta teknike të hetimit; siç ishin – nxjerrja e hyrje dalje dhe SMS për të pandehurit A.H, L.B, B.P dhe A.B.1 janë mbledhur në kundërshtim të plotë me frymën dhe kërkesat ligjore për urdhërimin e këtyre masave. Gjykata rikujton standardin ligjor që parashihet me nenin 86 par.2 i KPPRK-së i cili përcakton se: “pas fillimit të procedurës penale ose të njëjtën kohë me aktvendimin e prokurorit të shtetit për të filluar procedurën paraprake, prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që ta autorizoi masat e fshehta teknike të hetimit në pajtim të nenit 86 dhe 100 të këtij Kodi. Sipas këtij përkufizimi ligjor, rrjedh se masat e fshehta teknike të hetimit mund të autorizohen vetëm pasi të filloi procedura penale-pasi të filloi hetimi zyrtar me aktvendimin për fillimin hetimeve nga ana e prokurorit të shtetit. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nga ky rregull ka vetëm një përjashtim, që përcaktohet me nenin 84 të KPP-ës, i cili e lejon urdhërimin e masave të fshehta teknike të hetimit edhe pa filluar procedura penale por me të vetmin përjashtim në mungesë të identitetit të të pandehurit. Ndërsa neni 84 par.4 i KPPRK-së, përcakton “procedura penale nuk kërkohet të jetë filluar për autorizimin nga prokurori i shtetit apo gjyqtari i procedurës paraprake të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nga par.1 (sqarim i gjykatës i referohet nenit 84 par.1 të KPPRK-së), sidoqoftë, procedura penale fillohet posa prokurori i shtetit të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo dyshuarve që kanë kryer veprat penale. Në rastin konkrete kur është lëshuar masa e fshehte është lëshuar urdhri është lëshuar me emrat dhe mbiemrat e të pandehurve, çka do të thotë se prokuroria por edhe gjykata kanë qenë të njoftuar për identitetin të pandehurve. Në mënyrë të drejtpërdrejtë vlejné rregullat ligjore sipas nenin 86 par.2 i KPPRK-së. Vlerësimi i gjykatës në lidhje provave – traskriptet e siguruara përmes masave të fshehta për të pandehurve, sipas urdhëresave PNKR.482/2013 të datës 20.12.2013 si dhe urdhëresën e datës 07.02.2014 me të gjitha traskriptet e përgjimeve të renditura sipas provës materiale me numër rendor 25 dhe 30 të procesverbalit të datës 15.10.2024, provat e tilla të siguruara përmes këtyre masave janë provat plotësisht të papranuara, sepse janë siguruar në kundërshtim të plotë me

nenin 86 par.2 të KPPRK-së, sepse ishin siguruar në mungesë të aktvendimit mbi fillimin e hetimeve. Gjykata, në përputhje me nenin 97 par.1, 2, 3 të KPPRK-së, e në mbështetje të nenit 249 dhe nenit 257 par.1, 2, 3 të KPPRK-së, konsideron se provat e marrë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, andaj si të tilla i ka shpallur si prova të papranueshme.

Gjithashtu sipas nenit 92 të KPPK-së përcaktohet në mënyrë shprehimore se një urdhër i tillë nuk duhet të kalojë periudhën prej 60 ditësh nga data e lëshimit.

Duke pasur parasysh parimet e përgjithshme të përcaktuar nga GJEDNJ, dispozitat relevante të KPP-së dhe ligjit për komunikimin elektronik rezulton se përgjimet retroaktive duke përfshirë nxjerrën dhe leximin e mesazheve SMS në mënyrë retroaktive është e ndaluar. Rrjedhimisht gjykata vlerëson se nxjerra e një përmbajtje të SMS në mënyrë retroaktive nuk është një masë e paraparë me ligj ashtu siç kërkohet në parimin e të drejtës së privatësisë e garantuar në nenin 36 të kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ kjo për më tepër duke pasur parasysh se neni 92 i KPP-së përcakton në mënyrë shprehimore se urdhri për përgjime nuk duhet të kalojë 60 ditë.¹

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk ka dëgjuar të dëmtuarit-dëshmitarët: A.K, B.Q, B.I, B.R, E.P, E.M, H.C, I.F, I.S, I.M, J.M, K.G, M.B, N.M, S.O, S.E, SH.B, SH.A, S.G, T.G, XH.P, A.H, E.A dhe G.H, pasi që prokurorja e shtetit me parashtresën e datës 08.08.2024 ka heqë dorë nga dëgjimi i tyre.

Lidhur me vendimin për pikën IX dhe X të dispozitivit të këtij Aktgjykimi

Gjykata vendosi si në pikën IX të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndaj të akuzuarve: L.B, B.P dhe B.Z, (të akuzuar sipas pikës VII të aktakuzës), pasi që për veprën penale në bashkëkryerje Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike nga neni 262 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, gjykata duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, ka konstatuar se për këtë veprë penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes, pasi që për këtë veprë penale parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. E që sipas nenit 106 par.1 pika 1.6 të KPRK-së, vepra penale e cila është e dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë parashkruhet kur të kanë kaluar dy (2) vite nga data e kryerjes së veprës penale, ndërsa në bazë të nenit 107 par.8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, e në rastin konkret kanë kaluar katër (4) vite, përkatësisht dyfishi

¹ Aktgjykimi i gjykatës kushtetuese me numër KII12/21, nr. Reference AGJ1932/22 të datës 05.01.2022

nga kryerja e veprës penale e cila i vihet në barrë të pandehurit, e cila është kryer me datë 31.12.2015, ndërsa parashkrimi absolut ka arritur me datë 31.12.2019.

Gjykata vendosi si në pikën X të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndaj të akuzuarve: B.P, N.SH. “D...” - (person juridik), N.Z dhe NSH. “Z...” - (person juridik), (të akuzuar sipas pikës X të aktakuzës), pasi që për veprën penale Shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur më par.1 të KPRK-së, gjykata duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, ka konstatuar se për këtë vepër penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes, pasi që për këtë vepër penale parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. E që sipas nenit 106 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, vepra penale e cila është e dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim, parashkruhet kur të kanë kaluar pesë (5) vite nga data e kryerjes së veprës penale, ndërsa në bazë të nenit 107 par.8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, e në rastin konkret kanë kaluar dhjetë (10) vite, përkatësisht dyfishi nga kryerja e veprës penale e cila i vihet në barrë të pandehurit, e cila është kryer me datë 01.01.2014, ndërsa parashkrimi absolut ka arritur me datë 01.01.2024.

Dorëzania:

Vendimi për kthimin e dorëzanisë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, është marr në kuptim të nenin 180 par.3 të KPPRK-së

Kërkesa pasurore juridike:

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 par.3 të KPPRK-së.

Shpenzimet e procedurës:

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPK-së.

Në bazë të arsyeve të dhëna si më lartë, e në bazë të nenit 363 par.1, nënpar.1.3 dhe nenit 362 par.1, nënpar.1.3, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.41/2018, datë 05.12.2024

G j y q t a r i

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.